



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë

“Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Klodiana GORICA

. Asoc. Prof. Dr. Ermelinda KORDHA

Korrik 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural"
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Bujqësor i Tiranës"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Bujqësor i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomise dhe Politikava te Zhvillimit Rural
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdher I MASH Nr 408 date 25.07.2019
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli I pare
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180
11	Forma e studimit:	Me kohe te plote
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	18 PAE 2 Prof Dr 9 Prof/As 6 Dr 1 Msc
18	Numri i studentëve:	90 studente
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Ky program vlerësohet në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017”.

Programi që vlerësohet është Bachelor në "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural" ofruar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës.

UBT, universiteti më i vjetër në Shqipëri, ka mundësi të kthejë eksperiencën e akumuluar në histori suksesi dhe ekselence ashtu si e ka demonstruar deri tani. I themeluar më 1 Nëntor, 1951, fillimisht ka funksionuar si Instituti i Lartë Bujqësor dhe më tej gjatë historisë së tij, me Vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Nr. 166, datë 28.05.1991, i është akorduar statusi i Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, stafi i ftuar dhe e gjithë infrastruktura e ndertuar dhe e mirkurrur është në mbështetje cilësore të këtij procesi mësimdhënie dhe mësimnxënie që reflektohet në kërkesën në rritje që tregu ka për këtë diplomë e cila nga ana tjetër mbështetet dhe furnizohet me cka prodhojnë analizat dhe studimet e tregut duke reflektuar me një feedback të shëndetshëm në përmirësimin e vazhduar të cilësisë së proçmit mësimor. Marrëdhëniet me bizneset efektive në tregun vendas e bën më të kërkuar këtë diplomë në tregun vendas. Marrëdhëniet me ndërkombëtares dhe reflektimi i eficensës së këtyre marrëdhënieve në diploma konkrete të ciklit të dytë kanë certifikuar dhe siguruar jo vetëm vazhdimësinë e këtij programi por siguruar një unikalitet në tregun vendas dhe më tej edhe atë rajonal, duke kthyer UBT në një lider të ofrimit të këtij programi studimi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Procesi i vlerësimit të jashtëm paraqitet si një proces që ka ndjekur hapat rigoroze të cilat janë në zbatim të ligjit për arsimin e lartë dhe gjithë bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë ASCAL

Procedura përfshiu fillimisht diskutim midis ekspertëve pjesë e GVJ mbi standartet e cilësisë dhe kriteret. Cilësia e mëtejshme e punës së GVJ, u ndikua nga cilësia e dokumentacionit dhe diskutimet e mëtejshme. Instalimi i komunikimit të mirë në grupin e punës midis ekspertëve dhe ekspertit teknik ishte një hallkë e rëndësishme për ecurinë e procesit. Pas njohjes dhe shfrytëzimit të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni për diplomën përkatëse, u ndërtua një axhendë për vizitën në institucion dhe hapi i radhës natyrshëm ishte realizimi i saj. Agjenda u zbatua me rigorozitet, duke ndikuar pozitivisht në mbledhjen dhe grumbullimin e informacioneve të mëtejshme të cilat do të ndikonin në një vlerësim bazuar mbi informacion sa më të detajuar. Takimet me Drejtuesit e fakultetit dhe të departamentit, më pas me GVB, pedagogët e programit dhe studentët si edhe me zyrat përkatëse në nivel rektorati, ishin efektive në vijimësinë e procesit për të realizuar RVJ. Pas vizitës në terren u realizua raporti përfundimtar nga ekspertët e jashtëm dhe ky u dorëzua për rishikim nga ASCAL dhe për njohjen me të të GVB.

MEMO



Në zbatim të Ligjit 80 2015, për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, dhe në vijim të procesit të vlerësimit të jashtëm për programin e studimit *Bachelor në "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural"*, GVJ I përbërë prej Prof. Dr. Klodiana Gorica dhe Prof. Asoc. Dr. Ermelinda Kordha ju drejtohet me këtë memo, në përgjigje të komenteve të dërguara nga institucioni me dokumentin e datës 01.06 2023.

Duke mbajtur parasysh procesin e vlerësimit të jashtëm, në vijim të tij dhe pas leximit të argumentimit, ju bëjmë me dije se jemi dakort me argumentet e dhena nga komentet dhe RVJ ka ndryshuar perkatesisht sipas komenteve.

Ju faleminderit!

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof. Dr. Klodiana Gorica
Prof. Asoc. Dr. Ermelinda Kordha



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) është Institucion Publik i Arsimit të Lartë (IPAL) i lloji Universitet, i pavarur nga çdo orientim fetar, ideologjik dhe politik, me liri akademike, autonomi financiare dhe organizative i cili financohet nga shteti dhe burime të tjera të ligjshme.</p> <p>UBT është institucion i arsimit të lartë, qëllimi kryesor i të cilit është përparimi i shkencës në fushën e bujqësisë, teknologjisë bujqësore dhe arsimit të lartë nëpërmjet koordinimit të tyre dhe një vizioni afatgjatë. UBT promovon dhe rrit rolin e tij në procesin e zhvillimit të bujqësisë, përmes transferimit të teknologjive dhe informacionit si dhe përmes shërbimeve të ekstensionit bujqësor.</p> <p>Programi i studimit jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtare por synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, i shërben direct sektorit specifik dhe në mënyrë direkte të gjithë ekonomisë shqiptare duke ndikuar fort edhe në rritjen dhe cilësinë mbarëkombëtare të mësimdhënies, kulturës dhe vlerave akademike kombëtare.</p> <p><i>Aneks UBT Statut 2021, Neni 3, Pika 4</i> <i>Aneks UBT Statut 2021, Neni, 1 dhe 2</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Mbështetur në dokumentat më të rëndësishëm strategjike të institucionit të lartë, të njësisë bazë dhe asaj kryesore vihet re një përputhje cilësore në arritjen e objektivave, në metodologjinë, në qasjen e qartë si dhe në mbështetjen që institucioni ka dhe kryen në përputhje me qëllimet dhe misionin e tij sikurse edhe në fushën e veprimtarive.</p> <p>Komentet e mëposhtme janë rezultat i këtyre dokumenteve dhe që mbështesin këtë kriter.</p> <p>Programi që ofrohet nga ky departament, dhe që është në përputhje me qëllimet dhe misionin e UBT të përmendura më sipër dhe të përcaktuara në dokumentet themelore të tij si Statuti, Rregullore e Studimeve Universitare, Planin e Zhvillimit Strategjik etj., si dhe me fushat e veprimit të tij, synojnë pajisjen e studentëve me njohuritë bazë mbi shkencat e ekonomisë bujqësore, sipas profilit përkatës.</p> <p><i>Kjo është e bazuar vecanerisht edhe në Rregullore FEA2017, miratuar më datë 29.09.2017, Neni 19, Pika 1.</i></p> <p>Nga ana tjetër, Departamentet e FEA si njësi bazë të zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të këtij fakulteti, përfshijnë fusha kërkimi të përafërta midis tyre dhe grujonjë disiplina mësimore respektive midis tyre dhe në përputhje me fushën kryesore të këtij fakulteti që është Ekonomia Bujqësore dhe Agrobiznesi</p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim	

<p>të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Programet ofrohen në përputhje me misionin dhe vizionin e FEAs, dhe Departamenteve brenda tij dhe në përputhje me strategjinë për zhvillimin e FEA-s.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe programet e ofruara nga Institucione të tjera të Arsimit të Lartë.</p> <p>Ky program studimi perben nje nder programet me te konsoliduara te hershme dhe nderkohe dhe me te kerkuarat ne UBT. FEA ofron programe studimi të ciklit të parë, dytë dhe tretë në profile të ndryshme të fushës së shkencave të ekonomisë bujqësore dhe pas përfundimit të tyre lëshon diplomat përkatëse si Menaxhim Agrobiznesi, Ekonomi dhe Politika Agrare, Menaxhim i Turizmit Rural, etj.</p> <p><i>Aneks Rregullore FEA2017, miratuar më datë 29.09.2017, Neni 19, Pika 1 dhe 2, Neni 21</i></p> <p><i>Aneks Rregullore FEA2017, miratuar më datë 29.09.2017, Neni 19, Pika 1.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p> <p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>UBT, universiteti më i vjetër në Shqipëri, ka mundur të kthejë eksperiencën e akumuluar në histori suksesi dhe ekselence ashtu si e ka demonstruar deri tani. I themeluar më 1 Nëntor, 1951, fillimisht ka funksionuar si Instituti i Lartë Bujqësor dhe më tej gjatë historisë së tij, me Vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Nr. 166, datë 28.05.1991, i është akorduar statusi i Universitetit Bujqësor të Tiranës.</p> <p>Stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, stafi i ftuar dhe e gjithë infrastruktura e ndërtuar dhe e mirëkruar është në mbështetje cilësore të këtij procesi mësimdhënie dhe mësimnxënie që reflektohet në kërkesën në rritje që tregu ka për këtë diplomë, e cila nga ana tjetër mbështetet dhe furnizohet me atë cka prodhojnë analizat dhe studimet e tregut duke reflektuar me një feedback të shëndetshëm në përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit mësimor. Marrëdhëniet me bizneset efektive në tregun vendas i bënë më të kërkuar këtë diplomë në tregun vendas. Marrëdhëniet me ndërkombëtarët dhe reflektimi i efikasitetit të këtyre marrëdhënieve në diploma konkrete të ciklit të dytë kanë certifikuar dhe siguruar jo vetëm vazhdimësinë e këtij programi por siguruar një unikalitet në tregun vendas dhe më tej edhe atë rajonal, duke kthyer UBT në një lider të ofrimit të këtij programi studimi.</p> <p>FEA-ja, dhe DEPZHR-ja në vecanti, është e specializuar në fushën e ekonomisë bujqësore, politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural, dhe programi Bachelor EPZHR korrespondon plotësisht me fushën akademike të njësisë bazë/departamentit (DEPZHR) që është përgjegjëse për këtë program studimi.</p> <p>Ky program ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe analitike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Këto objektiva në përputhje me misionin dhe fushat e veprimtarisë së UBT i referohen Nenit 3 pikës 1 të Aneks 2 UBT Statut 2021.</p> <p>UBT ka për mision edukimin profesional dhe kërkimin shkencor në Fushat prioritare të përmendura më sipër</p> <p><i>Aneks Plani strategjik UBT_2016-2025_ Qershor 2016, Misioni dhe Vizioni i UBT, Paragrafi 3 Fq5</i></p>

	<p>Nga ana tjetër, UBT synon të jetë qendra më e madhe dhe ekselente e edukimit në të tre ciklet e studimit, kërkimit shkencor dhe e transferimit të njohurive në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.</p> <p>Plani Strategjik i UBT_së miratuar në Qershor 2016 ndërthur vizionin tonë për arsimin e lartë, në përgjigje të sfidave, me hapa praktike të nevojshëm në shpërndarjen e kontributeve tona në përgjigje të detyrave që burojnë nga procesi i Bolonjës. Vizioni strategjik është integrimi rajonal, europian dhe global i arsimit të lartë bujqësor.</p> <p>Ndërtimi i programeve udhëhiqet nga nevojat e biznesit dhe fleksibiliteti, për t'iu përgjigjur përfituesve (tregut të punes).</p> <p>Programet e studimit të FEA_s, si pjesë integrale në strukturën e UBT, kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe analitike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij në të tre ciklet. Ato synojnë pajisjen me njohuritë bazë mbi shkencat e ekonomisë bujqësore, sipas profileve përkatëse .</p> <p><i>Aneks Plani strategjik UBT_2016-2025, Misioni dhe Vizioni i UBT -së, Fq 32, 1.2. Vizioni Strategjik, Paragrafi 2</i></p> <p><i>Aneks Plani strategjik UBT_2016-2025, Misioni dhe Vizioni i UBT -së, Fq 6, 1.2. Vizioni Strategjik, 4.1.1, Paragrafi 1</i></p> <p><i>Aneks Plani strategjik UBT_2016-2025, Misioni dhe Vizioni e UBT-së, Fq 5 Paragrafi 1</i></p> <p><i>Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare, 2021, Kreu IV "Studimet e Ciklit të parë në UBT"</i></p> <p><i>Rregullore e Brendshme e FEA-s, 2017.</i></p> <p><i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural", 2022</i></p> <p><i>https://ata.gov.al/2022/02/23/universiteti-bujqesor-mbyll-aplikimet-per-doktoraturat-ne-universitetet-e-be-se/</i></p> <p><i>Pedagogët e Ftuar ne FEA per Vitin Akademik 2022-2023</i></p> <p><i>Pedagogët e Ftuar në FEA për Vitin Akademik 2022-2023</i></p>		
Konkluzione	<p><i>Njësia bazë që ofron këtë program studimi është Departamenti Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural (DEPZHR) i cili ka ofruar këtë program studimi prej dekadash, në mënyrë cilësore, duke realizuar studime të herëpashershme të tregut, duke përdorur instrumenta të ndryshme dhe cilësore të testimit të këtij programit dhe njohurive që përcjell, duke patur të gjitha kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore në mbështetje të realizimit të këtij programi.</i></p> <p><i>FEA-ja, dhe DEPZHR-ja në vecanti, është e specializuar në fushën e ekonomisë bujqësore, politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural.</i></p> <p><i>Programi Bachelor EPZHR korrespondon plotësisht me fushën ademike të njësisë bazë/departamentit (DEPZHR) që është përgjegjëse për këtë program studimi.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësisive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>E shprehur edhe sipas mendimit të Dekanit të FEA-s, Programi Bachelor në DEPZHR plotëson kërkesat specifike në fushat e ekonomisë dhe politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, bazuar në një kurrikul bashkëkohore në zhvillim të vazhdueshëm që integron trendet e reja shkencore dhe profesionale, dhe që ofrohen nga një grup i kualifikuar pedagogësh që përmbledh ekspertët më të mirë të fushës në Shqipëri.</p> <p>Është e dukshme edhe në raport por edhe nga diskutimet dhe vizitat në terren se ekziston një ndarje e mirëorganizuar midis të gjithëve njësisive dhe personelit, dhe se ky program studimi është fryt i një përpjekjeje të kahershme dhe të përbashkët të të gjithë strukturave të UBT dhe FEA.</p> <p>Përgjatë punës, përvec mbështetjes së plotë dhe të gjithëanshme nga strukturat e FEA-s, rezultoi se ky program është mbështetur edhe nga strukturat në nivel universiteti, si psh: Biblioteka, Zyra e Studimeve dhe Studentëve, Drejtoria e Menaxhimit të Personelit dhe Pagave, Dega e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional, etj.</p> <p>Se fundmi, sipas të gjitha rregulloreve në vijueshmeri të njera tjetres, por vecanerisht rregullores së këtij programi studimi:</p> <ol style="list-style-type: none">programet hartohen nga titullari i disiplinës, pedagogu i disiplinës ose grup pedagogësh,me tej, shqyrtohen në grupin e mësimit dhe të kërkimit, në departament dhe,miratohen nga përgjegjësi i departamentit dhe nga Dekani i FEA-s. <p><i>Mendimi Dekanit, Bachelor, EPZHR, 2023</i> <i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në "Ekonomi dhe Politikë dhe Zhvillimit Rural", 2023, neni 5 pika 5</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>DEPZHR-ja është njësi bazë unike në mbarë vendin dhe programi Bachelor, që ofrohet në përputhje me fushat e ekspertizës që disponon ky departament, është gjithashtu unik. DEPZHR-ja ka një eksperiencë të gjatë dhe kualifikim të lartë akademik dhe profesional.</p> <p>Për të realizuar aktivitetin e mësimit dhe objektivat e procesit mësimor në të gjitha programet e UBT, janë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me homologët brenda dhe jashtë vendit si dhe me aktorë të biznesit vendas dhe të huaj. Kjo është e garantuar nga Liria Akademike dhe shprehur në nenin 3, pika 1.e.; në autonominë organizative shprehur në nenin 3, pika 3.c.; Neni 15. Pika 18 e Statutit të UBT</p> <p>Marrëdhëniet me bizneset efektive në tregun vendas i bën më të kërkuar këtë diplomë në tregun vendas. Marrëdhëniet me ndërkombëtares dhe reflektimi i efikasitetit të këtyre marrëdhënieve në diploma konkrete të ciklit të dytë kanë certifikuar dhe siguruar jo vetëm vazhdimësinë e këtij programi por siguruar një unikalitet në tregun vendas dhe më tej edhe atë rajonal.</p> <p><i>Raport i Bashkëpunimit Institucional brenda dhe jashtë vendit, UBT 2022 dhe Tabela 5</i></p>

	<p><i>Raport i Bashkëpunimit Institucional brenda dhe jashtë vendit, UBT 2022</i> <i>Statuti i UBT-së, 2021, neni 58, pika 7</i> <i>Analiza mësimore dhe kërkimore 2019-2020;</i> <i>Analiza Mësimore dhe kërkimore</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Në vizionin e tij afatgjatë, Universiteti Bujqësor i Tiranës në të tre nivelet e arsimit të lartë, synon të bëhet qendra ekselente më e madhe e edukimit universitar, kërkimit dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të specialistëve të fushës së bujqësisë, në drejtim të zhvillimit të bujqësisë moderne dhe garantimit të ushqimit të shëndetshëm dhe cilësor.</p> <p>Marrëveshjet midis UBT dhe institucioneve dhe bizneseve të ndryshme, janë marrëveshje të cilat sipas specifikave parashikojnë vizita, shkëmbime, asistencë studentëve dhe te praktikave të tyre mësimore. Ekzistojnë shumë marrëveshje të realizuara nga UBT me institucione dhe biznese kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të realizimit të praktikave profesionale të studentëve të programeve të ofruara në UBT, në FEA dhe të programit në veçanti.</p> <p>Gjithashtu UBT dhe FEA kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të huaja dhe të vendit për projekte kërkimore të përbashkëta, shkëmbim dhe mobilitete personeli akademik, studentë të doktoraturës. Në këtë kuadër vlen të përmendet zhvillimi i një periudhe të kërkimit të doktoraturës të studentëve Shqiptarë në Institucione të Kërkimit dhe Universitete kryesisht në Gjermani në vitin akademik 2021-2022.</p> <p>UBT ka marrëveshje me programin ERASMUS+ dhe janë realizuar vazhdimisht trajnime dhe mobilitete të personelit akademik dhe studentëve në shtete të ndryshme të BE</p> <p><i>Aneks UBT Statut 2021, Neni 3, Pika 2 dhe 3</i> <i>Raport i Bashkëpunimit Institucional brenda dhe jashtë vendit, UBT 2022 dhe Tabela 5</i> <i>Raport i Bashkëpunimit Institucional brenda dhe jashtë vendit, UBT 2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit ka ardhur si riorganizim i programit nga Bachelor "Ekonomi dhe Politikë Agrare" ne Bachelor "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural" me UMASR Nr. 408, date 25.07.2019. Duke ndërthurur edukimin me kërkimin shkencor dhe transferimin e njohurive te të tretët, në nivel të lartë, UBT kërkon të përgatisë jo vetëm specialistë të kualifikuar të fushës së bujqësisë, të ushqimit dhe mjedisit, por edhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë.</p> <p>UBT dhe FEA në synimin për të rritur nivelin e përgatitjes së studentëve të programeve të studimit dhe të personelit akademik përveçse synon të zgjerojë marrëdhëniet, të shtojë partnerët bën edhe një vlerësim të përfitimeve reciproke dhe shkëmbimeve të ndryshme dhe në këtë kuadër përcakton edhe partnerët më të rëndësishëm dhe bashkëpunimet më të rëndësishme dhe premtuese për të ardhmen.</p> <p><i>Aneks 14 Plani strategjik UBT_2016-2025_Miratar, Qershor 2016, Misioni dhe Vizioni i UBT-s, Paragrafi 2, Fq 5</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në kuadrin e raporteve të përvitshme të analizës së veprimtarisë së njësisë bazë dhe njësisë kryesore, theksohen çështjet kryesore që kanë të bëjnë me bashkëpunimin me aktorë / institucione të tjerë në funksion të programeve të studimit.</i></p>

	<p><i>Aktualisht UBT-ja ka rreth 140 marrëveshje aktive bashkëpunimi me partnerë të ndryshëm brenda dhe jashtë Shqipërisë.</i></p> <p><i>Sipas rregullores së programit të studimit "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural" programet hartohen nga titullari i disiplinës, pedagogu i disiplinës ose grup pedagogësh, shqyrtohen në grupin e mësimit dhe të kërkimit, në departament dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit dhe nga Dekani i FEA-s.</i></p> <p><i>Hartimi i programeve bazohet në një bashkëpunim midis hallkave të ndryshme në nivel departamenti dhe fakultateti. Cdo vit kryhet analiza e punës mësimore (dhe kërkimore) në nivel departamenti dhe fakulteti, ku reflektohen dhe arrijtet dhe problematikat.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Ky program studimi është reflektim i studimit të tregut në 2019 kur u bë riorganizimi dhe të një studimi tjetër të mëvonshëm i cili rikonfirmon strukturën e planit mesimor. Plani mesimor i ka të gjithë elementet që duhet të përmbajë. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lendet ndryshojnë nga numri i krediteve dhe i orëve mesimore nga organizimi dhe përfshirja në grupe të ndryshme, etj.</p> <p>Programi i studimit është i ndërtuar sipas Rregullores së Programit. Programi është i detajuar sipas planit mesimor i cili zbërthen çdo modul në orë dhe kredite. Kjo ngarkesë përkthehet në 2325 orë e e përbërë nga 930 orë leksione dhe 870 orë seminare si edhe një numër i caktuar i orëve të praktikës profesionale (300 orë) përkthyer në 12 kredite.</p> <p><i>Statuti i UBT-së, 2021, neni 60</i> <i>Rregullore e Brendshme e FEAs, 2017, neni 19</i> <i>Plani Strategjik i UBT-së 2016-2025, pika 4, faqe 33</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose</p>	<p>Ky program studimi përben një miks të kujdeshëm dhe cilësor të shumë elementeve.</p> <p>Programi i studimeve të ciklit të parë në "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural" synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh si: ekonomist agrar, ekonomist i mjedisit dhe</p>

¹ Plani mesimor për programin EPZHR 2022-2023

punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

burimeve natyrore, ekonomist në njësitë e qeverisjes lokale, menaxher, specialist marketingu, si dhe mundësi të tjera si: gazetari (ekonomike), mësimdhënie, asistencë në aktivitete kërkimore shkencore, specialist në projekte zhvillimore, konsulencë etj.

Me qellim që ky plan mesimor me strukturën e vet në përberje, me lëndet baze e me zgjedhje, me të gjithë shpërndarjen e moduleve dhe ngarkesës mesimore në ore dhe kredite të optimizojë maksimalisht njohuritë e mara sipas profilizimit që ofron diploma, u sugjeruan dhe dakortësuan sa më poshtë vijon disa elemente të cilët i referohen pikerisht këtij plani mesimor:

- Lëndet me zgjedhje dhe përafrimi i tyre me profilin e fushës së cilës i shërben diploma dhe rritjen e me shumë njohurive teknike dhe të profilizuara. Për këtë u sugjerua që të përfshihen me shumë lëndë të profilit tek lëndet me zgjedhje. Argumenti i dhënë nga drejtuesi i departamentit përben një argumentim të fortë. Kështu, gjatë vizitës në institucion u sugjerua për të patur vetëm lëndë të profilit në lëndet me zgjedhje. Sipas mendimit të drejtuesit të departamentit theksohet se kjo do të ishte për kushtet e një tregu pune perfekt, pasi në jetojmë në një treg pune jo perfekt që do të thote se studenteve u duhet të zgjerohen njohuritë për elemente shtesë finance për t'u përshtatur me mirë tregut. Studentet kanë nevojë për elemente finance sepse në të ardhmen mund të jenë financiere në agjensite lokale të zhvillimeve rurale. Megjithatë ky sugjerim qëndron dhe gjykohet i rëndësishëm për përmirësimin e qëllimit të gruplëndës me zgjedhje kanë në fund të fundit. Lëndet me zgjedhje në mundësi plotësojnë këto mungesa, këto lëndë me zgjedhje pavarësisht se nuk janë në profilin e programit por mundësojnë formimin e plote të studenteve.
- Cilësia e lendeve të përfshira në planin mesimor mund të përmirësohet me lëndë me koherente dhe të kohës, si psh. Lëndë si teknologjia e informacionin në profilin apo fushën së cilës i shërben kjo diplomë është shumë më e vlefshme se sa lëndë tradicionale thjesht të informatikës.
- Shtimi i lendeve në fushën e turizmit përveç një lende që është aktualisht në këtë program Ekonomia e Turizmit, do të shtonte me shumë vlerë dhe profilizim. Të shtohen me shumë lëndë të agroturizmit. Për në fund, u dakortësuar për të shtuar me shumë lëndë të turizmit përveç lëndës aktuale të Ekonomisë së turizmit, sikurse edhe sugjerohet të shikohet mundësia e shtimit të me shumë lendeve të profilit si agroturizmi.
- Nevoja për me shumë praktike mesimore e cila erdhi dhe nga takimet me studentet por edhe nga diskutimet me drejtuesin e njësisë baze. Pra, duhet të forcohet me shumë pjesë e praktikave profesionale.
- Nevoja për të marketuar me shumë programin.


Programi është hartuar duke përfshirë disiplina të formimit të përgjithshëm si ato sasiore (Matematikë, Statistikë, Statistikë Biznesi, Ekonometri), dhe njohuri të aplikueshme të përgjithshme (Gjuhë e Huaj, Njohuri mbi Informacionin, Bazat e të Drejtës, Demografi, Informatikë), disiplina të formimit të shkencave të ekonomisë (përkatësisht Mikroekonomi, Makroekonomi, Ekonomik Institutional, Ekonomi Bujqësore, Ekonomi e

	<p>Burimeve Natyrore, Ekonomiks Publik), disiplina të menaxhimit e marketingut (Drejtimit i Fermave, Drejtimit Agrobiznesi, Menaxhim Karriere, Marketing), ato financiare (Financë, Kontabilitet, Tregjet dhe Institucionet Financiare, Paraja dhe Bankat), e të orientuara drejt bujqësisë (Prodhim Bimor, Prodhim Shtazor, Zhvillim Rural i Qëndrueshëm). Gjithashtu programi ofron fleksibilitet duke përfshirë disiplina formuese të zgjedhura nga studentët, praktikën mësimore dhe profesionale si dhe Temën e diplomës.</p> <p><i>Syllabuset e lëndëve për Programin e Studimit EPZHR 2022-2023</i> <i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në "Ekonomi dhe Politikën e Zhvillimit Rural", 2023</i> <i>Syllabuset e lëndëve për Programin e Studimit EPZHR 2022-2023</i> <i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në "Ekonomi dhe Politikën e Zhvillimit Rural", 2023.</i> <i>Plani mësimor për programin EPZHR 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi Bachelor në EPZHR realizohet me 180 kredite dhe ofrohet në gjuhën shqipe. Ai ka kohëzgjatje normale 3 vite akademike, përmban 6 semestra. Programi i studimeve të ciklit të parë në "EPZHR" synon përgatitjen e profesionistëve në fushat e ekonomisë dhe politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural që mund të kontribuojnë aktivisht në procesin e hartimit, vlerësimit dhe zbatimit të politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural. Praktika profesionale realizohet në semestrin e dytë të vitit të tretë të studimeve (12 ETCS). Kohëzgjatja dhe afati i kryerjes përcaktohen në strukturën e vitit akademik. Në përfundim të praktikës profesionale, student përgatit një relacion për punën e kryer, e cila vlerësohet në datën e caktuar nga Departamenti dhe komisioni i ngritur prej tij, pasi merr në konsideratë dhe vlerësimin e kompanisë ku është kryer praktika. Vlerësimi i praktikës profesionale në procesverbal bëhet me Fiton/ Nuk Fiton 2. Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve (Bachelor) në FEA diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome 3.</p> <p><i>Rregullore e Brendshme e FEA-s, 2017, neni 27</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Stafi akademik me kohe të plote dhe të pjesshme, stafi i ftuar dhe e gjithë infrastrukture e ndertuar dhe e mirekuruar është në mbështetje çilesore të këtij procesi mesimor dhe mesimor që reflektohet në kërkesën në rritje që tregu ka për këto diplome, e cila nga ana tjetër mbështetet dhe furnizohet me ato cka prodhojnë analizat dhe studimet e tregut duke reflektuar me një feedback të shëndetshëm në përmirësimin e vazhduar të cilësive të programit mesimor. Marrëdhëniet me bizneset efektive në tregun vendas i bëjnë me të kërkuar këto diplome në tregun vendas. Marrëdhëniet me ndërkombetaret dhe reflektimi i efikasitetit të këtyre marrëdhënieve në diploma konkrete të ciklit të dytë kanë certifikuar dhe siguruar jo vetëm vazhdimësinë e këtij programi por siguruar një unikalitet në tregun vendas dhe me tej edhe atë rajonal, duke kthyer UBT në një lider të ofrimit të këtij programi studimi.</p> <p>Pranimi në programet e ciklit të parë të studimeve është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm si dhe që plotëson:</p> <p>a. Kriterin e meritës (mesatare e shkollës së mesme) e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.</p>

² Rregullore e Brendshme e FEA-s, 2017, neni 27

³ Rregullore e Brendshme e FEA-s, 2017, neni 28

	<p>b. Kriterin e rëndësisë (koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit të FEA-s) sipas përcaktimeve të departamenteve.</p> <p>c. Notës mesatare me zgjedhje në fushën e ekonomisë. d. Kuotave të paracaktuara</p> <p>UBT financohet nga:</p> <p>a. buxheti i shtetit;</p> <p>b. pagesat e studentëve për arsimin;</p> <p>c. të ardhurat e krijuara nga të mësuarit përgjatë gjithë jetës;</p> <p>d. të ardhurat për shërbimet e kryera për subjekte publike e private vendase dhe të huaja si edhe ndaj studentëve; të ardhurat e krijuara nga veprimtaria kërkimore – shkencore etj</p> <p><i>Rregullore e Brendshme e FEA-s, 2017, neni 16</i> <i>Rregullore e Brendshme e FEA-s, 2017, neni 17</i> <i>Rregullore e UBT-së për Studime Universitare, 2021, neni 22, pika 2</i> <i>Rregullore e UBT-së për Studime Universitare, 2021, neni 22, pika 4</i> <i>Rregullore e Brendshme e FEA-s, 2017, neni 22, pika 4</i> <i>Statuti i UBT-së, 2021, neni 30</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi nxit një kombinim dijesh të aplikueshme në fushën e ekonomisë, financës, menaxhimit dhe i ofron fleksibilitet studentit për ndjekjen e lëndëve multidisiplinore. Njohuritë ofrohen duke harmonizuar metoda sasiore dhe cilësore të vlerësimit, të cilat pajisin studentët me dije dhe instrumenta të përshtatshëm për tregun e punës. Kjo reflektohet qartë në programet e lëndëve. Dijet ofrohen nëpërmjet materialeve bazë dhe ndihmëse të cilat reflektojnë eksperiencën didaktike të pedagogëve (cikël leksionesh), njohuritë e rifreskuara nga autorë bashkëkohorë (pasuruar me literaturë të viteve të fundit) si edhe materiale të tjera didaktike të aplikuara (studime, raporte, materiale teorike, artikuj shkencorë). Për këtë qëllim është motivuar përfshirja e librave mësimore të mirënjohur sidomos në disiplinat e ekonomisë, menaxhimit të burimeve natyrore, zhvillimit rural e të qëndrueshëm dhe bujqësisë. Lëndët ndërdisiplinore janë të shoqëruara me cikël leksionesh të shkruara dhe materiale ndihmëse. Në kompozimin e programit, prurjet teorike në retrospektivë historike zënë peshë të rëndësishme dhe në një pjesë të konsiderueshme theksohen argumentat për të rritur të menduarit kritik në auditor, duke i shoqëruar me raste studimore nga realiteti i vendit apo grup vendeve të tjera të ngjashme me realitetin tonë. Duhet të theksojmë se programi i studimit Bachelor Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural është unik në nivelin universitar.</p> <p><i>Statuti i UBT-së, 2021, neni 58, pika 3</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programet e ciklit të parë të studimit referuar nivelit 6-të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ETCS). Programi i Ciklit të parë të studimit, Bachelor në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural”, me kohë të plotë i ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë, Universiteti Bujqësor i Tiranës, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor me numër unik identifikimi: BU3146211075.</p> <p><i>Statuti i UBT-së, 2021, neni 60</i> <i>Statuti i UBT-së, 2021, neni 63, pika 1,3,4</i></p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të</p>	<p>UBT mund të organizojë me institucione të huaja të arsimit të lartë, programe studimi ose formime profesionale të larta mbi bazën e një marrëveshje “ad-</p>



përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	hoc”, e cila miratohet nga Senati akademik dhe BaUBT5. Aktualisht program Bachelor në EPZHR ofrohet vetëm nga UBT-ja por në të ardhme do të eksplorohehen mundësitë për programe të përbashkëta, duke ndjekur përvojën që ka DEPZHR-ja në nivel MSc. <i>Statuti i UBT-së, 2021, neni 63, pika 1,3,4</i> <i>Statuti i UBT-së, 2021, neni 63, pika 5</i> <i>Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare, 2021, neni 12, pika 1</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit të ciklit të parë “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural” është hartuar për të ofruar njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushat e ekonomisë dhe menaxhimit në përgjithësi dhe ekonomisë bujqësore e rurale në veçanti⁶. Programi ka si objektivi të aftësojë studentët në zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e ekonomisë dhe t’i orientojë ata drejt përbushjes së kërkesave për ekonomistë në njësitë ekonomike private dhe entitetet publike qendrore e lokale. Programet e lëndëve ofrojnë praktika dhe orë në auditor të fokusuar në instrumentet e kërkimit dhe metodat e vlerësimit. Gjithashtu programi ofron, ndryshe nga programe të tjera të ekonomisë, dije të ekonomisë bujqësore, qeverisjes së politikave rurale dhe menaxhimit.</i> <i>Programi i ciklit të parë të studimit “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural” (EPZHR), organizohet me jo më pak se 180 kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Veprimtaritë formuese të një programi studimi klasifikohen në: a.Module të formimit të përgjithshëm; b.Module të formimit karakterizues të programit; c.Module të formimit të ngjashëm ose/dhe integruese me modulet karakterizuese; d.Module formuese të zgjedhura nga studentët; e.Module formuese dhe aktivitete që lidhen me përfundimin e aftësive për të lehtësuar hyrjen në tregun e punës si: për njohje të gjuhës së huaj, informatikës, praktikës; f. Punimi i diplomës ose provimi i përgjithshëm përfundimtar</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht X

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	UBT dhe FEA kanë: <ul style="list-style-type: none">- Përvojë në mësimdhënie, organizim programesh studimi dhe kërkim shkencor- kapacitete kërkimi shkencor, të mësimdhënies, kapacitetet fizike të infrastrukturës si dhe administrative për të mbështetur Programin e Studimit- kapacitete të specializuara që plotësojnë njëra-tjetrën në nivel universiteti, fakulteti dhe departamenti:- burime njerëzore të specializuara, me eksperiencë të gjatë akademike dhe kërkimore, të mbështetura nga trajnimet në vazhdimësi gjatë gjithë karrierës dhe thellimit të përgatitjes nëpërmjet përgatitjes

⁶ Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural”, 2023

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>individuale, ekspertizës dhe konsulencës së bizneseve, shkrimit, drejtimit dhe zbatimit të projekteve etj.</p> <p>UBT është institucion i arsimit të lartë (IAL) me histori të gjatë, mbi 70 vjet, që e ka zanafillën në vitin 1951. Ky institucion ka ardhur duke u rritur, ristrukturuar dhe përmirësuar në vite në përputhje me ndryshimet ligjore dhe kuadrin rregullator në përgjithësi.</p> <p>UBT vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese profesionale dhe të transferimit të dijeve të tretët, në fushat: prodhim bimor, prodhim shtazor, hortikulturë; mbrojtje bimësh; akuakulturë dhe peshkim; agromjedis & ekologji; ekonomi agrare; politikat bujqësore; zhvillimi i integruar rural; menaxhimi i ndërmarrjeve; marketing; financë & kontabilitet; agroturizëm, turizëm rural, bioteknologji dhe ushqim; industri e pijeve; teknologji ushqimore, mbarështim i pyjeve; industri e drurit; mjekësi veterinarë & shëndet publik, etj.</p> <p>UBT ka mision të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë ... dijetsi edhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në fushën e bujqësisë, ekonomisë dhe zhvillimit rural, mjedisit dhe shkencave të natyrës, mjekësisë veterinarë, inxhinierisë pyjore, bioteknologjisë bujqësore dhe resurseve gjenetike;</p> <p>UBT ofron të gjitha nivelet e arsimit të lartë që u korrespondojnë niveleve 5, 6, 7 dhe 8 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve;</p> <p>Departamenti ka vecori specifike që ben në menyre të vazhduar studime të tregut të punës të mbështetura edhe nga zyra e karrierës për të t'iu pershtatur levizjeve të këtij tregu dhe përputhjes në çdo moment të diplomes me të. Çdo 2-3 vjet përditesohet me kërkime tregu për të kuptuar se ku leviz tregu i punës duke e kthyer këtë program studimi në bosht të departamentit dhe mbështetës të programeve të tera master dhe bachelor. Kjo përben një vecori çilesore që e rrit çilesinë e këtij departamenti.</p> <p>Koordinatori i programit të studimit është personel akademik i kategorisë “Profesor” me përvojë jo më pak se 10 vjet në mësimdhënie pranë njësive bazë, që ka përgjegjësinë për programin e studimit.</p> <p><i>Aneks 14 Plani strategjik UBT_2016-2025, Misioni dhe Vizioni i UBT, Paragrafi 2 Fq5</i> <i>Statuti i UBT-së, 2021</i> <i>Tabela 21, Analiza e Veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore 2021-2022</i> <i>Tabela 2, Personeli- Departamenti i EPZHR 2022-2023</i> <i>Analiza e Veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore 2021-2022, fq 32</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Sipas Rregullores së FEA-s autoritetet drejtuese akademike janë dekani dhe përgjegjësi i Departamentit. Përgjegjësi i Departamentit zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të departamentit, është personel akademik i kategorisë “Profesor” ose ka gradën shkencore “Doktor” (PhD), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Drejtuesi i departamentit mund të shërbejë në detyrë për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Drejton të gjithë veprimtarinë mësimore dhe shkencore në departament, përgatit dhe propozon kurrikulat e studimeve të departamentit, drejtime e profile të reja studimesh, projekte për programe të studimeve dhe të kërkimit shkencor; miraton programet mësimore të</p>

	moduleve; realizon bashkëveprimin ndërmjet grupeve mësimore – kërkimore etj. <i>Rregullore e Brendshme e FEA-s, 2017, neni 14, pika 2,3,4,6,13,14</i>		
Konkluzione	<p><i>Departamenti është përgjegjës për programin e studimit që ofron dhe e realizon kete proces ne menyre te qarte dhe sistematike. Departamenti ka në përbërjen e tij të paktën 7 anëtarë efektivë si pesonel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të kenë grada dhe tituj; mund të ketë në përbërje edhe personel ndihmës akademik; mund të krijohet edhe nga dy fakultete të ndryshme, për organizimin dhe realizimin e programeve të studimit me karakter ndërsiplinor.</i></p> <p><i>Departamenti i EPZHR, grupon fusha kërkimi të përafërta të cilat lidhen me ekonominë, politikat agrare dhe zhvillimin rural, si dhe instrumentat e analizës së të dhënave. Staf i DEPZHR përbëhet nga 18 pedagogë me kohë të plotë nga të cilët 11 të kategorisë profesor (2 anëtarë me titull Prof. Dr. dhe 9 anëtarë me titullin Prof. Asoc. Dr.), 5 pedagogë me gradën Doktor Shkencash, dhe 2 anëtarë me gradën Master i Shkencave.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3


Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural (EPZHR)” ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural (DEPZHR), në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA), në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT).</p> <p>Programi Bachelor në EPZHR është ndër programet më të konsoliduara të FEA-s, bazuar në një përvojë të gjatë bashkëpunimesh ndërkombëtare. Nga ana tjetër, programi është rishikuar vazhdimisht në përputhje me nevojat e kohës dhe legjislacionin në fuqi. Konkretisht, programi është riorganizuar me urdher të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 408, Datë 25 . 07. 2019, në përputhje me nivelin 6 të kornizës shqiptare të kualifikimit.</p> <p>FEA ka informacion të plotë për organizimin strukturën dhe përmbajtjen e studimeve. Kjo njësi ruan informacione të detajuara rreth planit mësimor të programit të studimit, shpërndarjes në module, kredite, dhe përmbajtjen e plotë të secilit prej moduleve. Këto informacione përditësohen në mënyrë periodike nëpërmjet procedurave të parashikuara në rregulloret e FEAs.</p> <p><i>Rregullore e Brendshme e FEA-s, 2017</i> <i>Rregullore e DZHKKVI & DITNJ, 2017 (ZSS)</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	<p>Plani mesimor eshte dokument jo vetem referues por shume strategjik pasi reflekton përpjekjet dhe përmledh të gjithë inputet e dokumentacioneve mbeshetese te cilat reflektohen ne qartesine dhe sakesine e ndarjes se oreve krediteve, moduleve, etj.</p> <p><i>Rregullore e Brendshme e FEA-s, 2017, nenet 75, 76, 77, 78</i> <i>Raporti i Performancës QKA, 2020</i> http://ubt.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit/</p>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Si nga vizita ne institucion, takimi me studentet ashtu edhe nga ballafaqimi me dokumentacionin perkates rezulton se e gjithë kjo procedure qe lidhet me te gjithë informacionin e nevojshem për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve eshte e organizuar plotesisht dhe eshte e qarte. Proçedurat e transferimit të studimeve dhe kriteret e ekuivalentimit tregohen në nenet 75, 76, 77 dhe 78 të Rregullores së FEAs.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i ciklit të parë të studimit “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural” (EPZHR), organizohet me jo më pak se 180 kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Veprimtaritë formuese të një programi studimi klasifikohen në:</p> <p>a.Module të formimit të përgjithshëm; b.Module të formimit karakterizues të programit; c.Module të formimit të ngjashëm ose/dhe integruese me modulet karakterizuese; d.Module formuese të zgjedhura nga studentët; e.Module formuese dhe aktivitete që lidhen me përfitim të aftësive për të lehtësuar hyrjen në tregun e punës si: për njohje të gjuhës së huaj, informatikës, praktikës; f. Punimi i diplomës ose provimi i përgjithshëm përfundimtar</p> <p>Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> <p>DEPZHR garanton kapacitet të mjaftueshëm si në numër pedagogësh ashtu edhe në marrëdhëniet entitete publike e private për realizimin e formimit praktik të studentëve dhe plotesimin e të gjithë komponentëve formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> <p>Rregullore e Brendshme e FEA-s, 2017, neni 52</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Programi është rishikuar vazhdimisht në përputhje me nevojat e kohës dhe legjislacionin në fuqi. Sektori i Programeve dhe i Kurrikulave ne UBT merret me problemet që lidhen me mësimin, me përgatitjen e programeve të reja për të gjitha ciklet e studimit , si dhe realizon rishikimin periodik të programeve ekzistuese. Në vitin akademik 2017-2018 u bë ndryshimi i kurrikulës së ciklit të parë të studimeve Bachelor dhe përshtatja e saj në 2.5 vite akademike (gjithsej 5 semestra mësim dhe një semester të plotë praktikë dhe përgatitje për mikrotezë ose provim përfundimtar). Kjo solli si rezultat dhënien e kohës së nevojshme studentëve për të kryer praktikën, por nga ana tjetër ka krijuar edhe një “ngjeshje” të moduleve dhe rritje të intensitetit të dijeve në pesë semestra.</p> <p>Pervec sugjerimeve te pefshira ne kriterin II.1 (kriteri 3), perghate vizites ne institucion, me drejtuesin e njesise baze u dakortesua dhe eshte kerkuar dhe synuar te gjendet mesatarja dhe ekuilibri I asaj qe kerkon profili I tregut te punes dhe asaj cka mund t’I ofrohet me mire studenteve. Keshtu p.sh u dakortesua me drejtuesin e njesise baze se sigurisht p.sh mund te kete nevojte per me shume lende te marketingut, apo per burime te riovueshme, por ne fakt ekziston nje master per ekonomine qarkulluese qe lidhet me burimet e</p>

	<p>rinovueshme, ka nje kurs per agjentet e zhvillimeve rural i cili analizon se si komunitetet mund te ngrihen drejt aplikimeve ne EU. Ekzistojne mundesite qe plotesohen ne menyre specifike ne programe te tjera mbeshtetese per kete program studimi. Jane pikerisht masterat qe vijojne dhe plotesojne nevojat me tej te ketij program Bachelor.</p> <p>Rishikimi, rivleresimi dhe trajtimi kritik i programeve, syllabuseve dhe planit mesimor eshte vecori tipike e departamentit qe e ofron kete program studimi. Gjatë këtij rishikimi vëmendje i kushtohet:</p> <p>a. rishikimit të shpërndarjes së krediteve për modulën apo grup - modulet përkatëse.</p> <p>b. rishikimit të programeve mësimore të moduleve të veçanta.</p> <p>c. rishikimit të elementëve përbërës të moduleve dhe ndarjen e krediteve ndërmjet tyre (leksione, seminare, detyra, projekte, laboratorë, etj.).</p> <p>d. rishikimi i rregullores së programit të studimit.</p> <p>e. rishikimi i bazës së nevojshme didaktike për realizimin e programit të studimit, evidentimi i mangësive dhe marrja e masave për vitin pasardhës.</p> <p>f. rishikimi i literaturës së përdorur, mungesat e vërejtura dhe masat për përmirësimin e situates.</p> <p>g. rishikimi i implementimit të programit të studimit në vitin përkatës akademik.</p> <p>h. rishikimi i procedurave të kontrollit të dijeve / provimeve dhe analiza e rezultateve të kontrollit. i. rishikim i feedback-ut të marrë nga student</p> <p><i>Rregullore FEA 2017, neni 93</i> <i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural", 2023</i> <i>Studim Tregu për programin EPZHR, 2022</i> <i>Rregullore FEA 2017, neni 7, pika 8</i> <i>Analiza e veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore 2019-2020, pika 1.1, fq.6</i></p>								
Konkluzione	<p><i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje e evidentuar në pjesën përshkrimore.</i></p> <p><i>Programi i studimit është objekt rishikimi periodik. Rishikimi bëhet para fillimit të vitit të ri akademik dhe synon të korrigjojë problemet që janë ndeshur gjatë procesit mësimor. FEA organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Dekani i fakultetit aktivizon komisionin ad-hoc për rishikimin e programeve të studimit dhe rregullores së tyre, i cili është përgjegjës për këtë proces.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për	Ky program studimi perben nje perpjekje cilesore e cila ne hap ate ndryshme te hartimit te tij karakterizohet qe nga kerkime te thelluara te tregut, mbeshtetje nga njesite e tjera t eintitucionit, perpjekje e cdo viti per permiresime te syllabuseve e programeve sikurse dhe me reflektim t etyre ne



<p>studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p> <p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>planin mesimor. Te gjitha sugjerimet e dakortesuara po permbledhen edhe njëhere ne kete seksion. Me reflektimin e tyre me shume njohuri profesionale do t eperfishihen ne lendet me zgjedhje me shume njohuri per turizmindhe koncepte bashkeohore te tij do te shtrihen n lidhjen qe turizmi ka dhe mbart ne vetvete per zhvillimet rurale, ne shtimin e me shume praktike profesionale, ne ofrimin e nje lende per teknologji informacioni per te rritur sa me shume karakterin inovativ te ketij program mesimor. Keshtu ne menyre te permbledhur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lendet me zgjedhje dhe perafrimi i tyre me profilin e fushes se ciles i sherben diploma dhe rritjen e me shume njohurive teknike dhe te profilizuara. Per kete u sugjerua qe te perfshihen me shume lende te profilit tek lendet me zgjedhje. Argumenti i dhene nga drejtuesi i departamentit perben nje argumentim te forte. Keshtu, gjate vizites ne institucion u sugjerua per te patur vetem lende te profilit ne lendet me zgjedhje. Sipas mendimit te drejtuesit te departamentit theksohet se kjo do te ishte per kushtet e nje tregu pune perfekt, pasi ne jetojme ne nje treg pune jo perfekt qe do te thote se studenteve u duhet te zgjerohen njohurite per elemente shtese finance per tiu pershtatur me mire tregut. Studentet kane nevojë per elemente finance sepse ne te ardhmen mund te jene financiere ne agjensite locale te zhvillimeve rurale. Megjithate ky sugjerim qendron dhe gjykohet i rendesishem per permiresimin e qellimit te gruplendet me zgjedhje kane ne fund te fundit. Lendet me zgjedhje na mundesoje plotesojne kete mungese, keto lende me zgjedhje pavaresisht se nuk jane ne profilin e programit por mundesoje formimin e plote te studenteve. - Cilesia e lendeve te perfshira ne planin mesimor mund te permiresohet me lende me koherente dhe te kohes, si psh. Lende si teknologjia e informacionin ne profilin apo fushen se ciles i sherben kjo diplome eshte shume me e vlefshme se sa lende tradicionale thjesht te informatikes. - Shtimi i lendeve ne fushen e turizmit pervec nje lende qe eshte aktualisht ne kete program Ekonomia e Turizmit, do te shtonte me shume vlere dhe profilizim. Te shtohen me shume lende te agroturizmit. Pra ne fund, u dakortesuara per te shtuar me shume lende te turizmit pervec lendes aktuale te Ekonomise se turizmit, sikurse edhe sugjerohet te shikohet mundesia e shtimit te me shume lendeve te profilit si agroturizmi. - Nevoja per me shume praktike mesimore e cila erdhi dhe nga takimet me studentet por edhe nga diskutimet me drejtuesin e njesise baze. Pra, duhet te forcohet me shume pjese e praktikave profesionale. - Nevoja per te marketuar me shume programin. <p><i>Analiza e veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore 2021-2022, pika 1.1, fq.8</i> <i>Relacion mbi axhustimet e kurrikulës Bachelor FEA, 2022</i> <i>Studim Tregu për programin EPZHR, 2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nje nder sugjerimet e dakortesuara pergjate vizites ne institucion ishte se ekziston nje nevojë per me shume praktike mesimore e cila erdhi dhe nga takimet me studentet por edhe nga diskutimet me drejtuesin e njesise baze. Pra, duhet te forcohet me shume pjese e praktikave profesionale.</p>

	<p>Krahasueshëm me programet ndërkombëtare, programi i ciklit të parë në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural ” synon të përgatisë ekonomistë agrarë për të punuar në nivel ferme apo ndërmarrje dhe institucionesh, me fokus zhvillimin rural dhe bujqësor, mundësuar kjo përmes kurrikulës së studimeve, e cila ofron për studentët njohje të thellë të teorisë së ekonomisë, njohje dhe përdorim shumë të mirë të metodave sasiore si dhe formim të thellë profesional.</p> <p>Lëndët e formimit të përgjithshëm dhe profesional të natyrës sasiore mbulojnë rreth 15% të lëndëve janë gjithashtu të hartuara sipas programeve bachelor të vendeve të tjera të BE-së.</p> <p><i>Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare, 2021, neni 19, pika 3</i> <i>Plani Mësimor Bachelor” Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural”, 2022-2023</i> <i>Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare, 2021, neni 69.</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi mbështetet në një bazë solide të kurseve të detyrueshme, por ofron fleksibilitet për të zgjedhur vetë kurset, kjo në semestrin e tretë, të katërt dhe të pestë. Kjo sjell mundësinë e të mbajturit të fokusit të përgjithshëm në politikat e zhvillimit rural por duke ruajtur edhe një tipar të specializimit në fusha të financës, ekonomiksit institucional ose menaxhimit. Programi në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural” në Universitetin Bujqësor të Tiranës edukon studentët për aplikimin e teorive ekonomike në një sërë situatash. Programet e lëndëve përpiqen në pjesën më të madhe të arrijnë tek studentit të menduarit si ekonomist dhe përdorimin e mjeteve sasiore kyçe të analizës që zbatohen në çështjet ekonomike. Në kurrikulën e programit rreth 30% e moduleve janë të orientuara tërësisht në ekonominë e zhvillimit rural dhe të krahasuara për nga kompozimi dhe përdorimi i literaturës me lëndë të programeve bachelor në ekonomi dhe politikat e zhvillimit rural në Evropë. Në lidhje me transferimet FEA në bashkëpunim me DEPZHR kryen ekuivalentimin e moduleve ose programeve të plota të studimit ose diplomave të marra në institucione të tjera të vendit ose të huaja mbas paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm nga të interesuarit. Mënyra e hartimit të programit të studimit, mundëson mobilitetin e studentëve. Gjithashtu departamenti është bashkëpunues me studentët për të lehtësuar praktikën dhe procedurat e njohjes së plotë apo të pjesshme të lëndëve që studentët mund të kenë realizuar në programe të mëparshme.</p> <p><i>Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare, 2021</i> <i>Plani Mësimor Bachelor” Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural”, 2022-2023</i> <i>Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare, 2021</i> <i>Rregullore e Brendshme e FEA-s, 2017</i> <i>Rregullore FEA 2017</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset i kanë të gjitha elementet e nevojshëm, të bollshëm në informacione dhe literature me një strukturë të mireorganizuar dhe të qartë e unike për të gjithë lëndët që përmban ky program studimi. Struktura dhe përmbajtja e programeve mësimore përputhet me udhëzimet e MAS. Nevojat e procesit mësimor dhe të studenteve me materiale didaktike janë të mbuluara mirë; me tekste, skripte, leksione, përmbledhje e prezantime, detyra, ushtrime, të dhëna e informacione të ndryshme, apo softe të nevojshme për studentët, të cilat janë të pasqyruara edhe në Web faqet personale të pedagogëve.</p> <p>Syllabuset janë të njohura për studentët, sepse janë të ekspozuara në faqen Web të universitetit si edhe në Web-et personale të pedagogëve. Po ashtu një kopje e syllabuseve të secilit modul për secilin cikël studimesh gjendet edhe pranë departamentit. Pjesa më e madhe, mbi 90% e programeve mësimore</p>

	<p>parashikojnë zhvillimin e detyravitë kursit, gjë që rrit punën e pavarur, punën në grup dhe lidhjen e çështjeve të studiuara me praktikën dhe prodhimin.</p> <p><i>Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare, 2021</i> <i>Plani Mësimor Bachelor "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural", 2022-2023</i> <i>Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare, 2021</i> <i>Rregullore e Brendshme e FEA-s, 2017</i> <i>Rregullore FEA 2017</i></p>			
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Oferta që jepet në nivelin bachelor është një ofertë që ka rezultuar e sukseshme në tregun e punës. Kjo gjë ndiqet në mënyrë të vazhduar nga departamenti dhe shihet analizohet se si mund të përmirësohen modulet për të qenë me prapësi tregut. Një student që mbaron 3 vjeçarën në këtë program studimi dhe ka të mundur të integrohet në tregun e punës. Kjo edhe për faktin e shumëllojshmërisë së lendeve që përmban ky program studimi.</p> <p>Meqenëse studentët e kanë të vështirë të orientojnë në tregun e punës, moduli i karrierës përmban të gjithë informacionin se si të hyjë në tregun e punës, si kërket një punë, instrumentat e kërkimit të punës, si përgatitet një cv, etj. Apo me tej, moduli njohuri mbi informacionin është i specifikuar në kontekstin e njohurive, në ndërtimin e një Website apo instrumentave të tjera që e bëjnë me specifike punën e tyre.</p> <p>Në përfundim të këtyre programeve studentët do të zotërojnë kompetenca dhe kapacitete analitike të nevojshme për të trajtuar problematikat teorike dhe praktike në fushën e programit të ndjekur. Në këtë kontekst, për programin "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural", Koordinatorin e programit në bashkëpunim me personelin akademik të përfshirë në këtë program janë angazhuar në përditësimin e programeve sipas kërkesave ligjore por edhe duke ju përmbajtur programeve të lëndëve të ngjashme në kurset bachelor për të njëjtin program studimi në universitete evropiane. Për të lehtësuar procesin e integritimit në tregun e punës, programi ka përfshirë në lëndet me zgjedhje edhe modulin "Menaxhim Karriere". Gjithashtu në bashkëpunim me Degën e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional është munduruar pjesëmarrja në panairin e karrierës, ku studentët kanë mundësi të njihen nga afër me biznese të ndryshme.</p> <p><i>Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare, 2021</i> <i>Plani Mësimor Bachelor "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural", 2022-2023</i> <i>Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare, 2021</i> <i>Rregullore e Brendshme e FEA-s, 2017</i> <i>Rregullore FEA 2017, neni 78, pika 2</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Meqenëse studentët e kanë të vështirë të orientojnë në tregun e punës, moduli i karrierës përmban të gjithë informacionin se si të hyjë në tregun e punës, si kërket një punë, instrumentat e kërkimit të punës, si përgatitet një cv, etj. Apo me tej, moduli njohuri mbi informacionin është i specifikuar në kontekstin e njohurive, në ndërtimin e një Website apo instrumentave të tjera që e bëjnë me specifike punën e tyre.</p> <p>Në përfundim të këtyre programeve studentët do të zotërojnë kompetenca dhe kapacitete analitike të nevojshme për të trajtuar problematikat teorike dhe praktike në fushën e programit të ndjekur. Në këtë kontekst, për programin "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural", Koordinatorin e programit në bashkëpunim me personelin akademik të përfshirë në këtë program janë angazhuar në përditësimin e programeve sipas kërkesave ligjore por edhe duke ju përmbajtur programeve të lëndëve të ngjashme në kurset bachelor për të njëjtin program studimi në universitete evropiane. Për të lehtësuar procesin e integritimit në tregun e punës, programi ka përfshirë në lëndet me zgjedhje edhe modulin "Menaxhim Karriere". Gjithashtu në bashkëpunim me Degën e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional është munduruar pjesëmarrja në panairin e karrierës, ku studentët kanë mundësi të njihen nga afër me biznese të ndryshme.</p> <p><i>Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare, 2021</i> <i>Plani Mësimor Bachelor "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural", 2022-2023</i> <i>Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare, 2021</i> <i>Rregullore e Brendshme e FEA-s, 2017</i> <i>Rregullore FEA 2017, neni 78, pika 2</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi i studimit "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural" ka synim të përgatisë specialistë të aftë në fushën e "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural", mundësuar kjo nëpërmjet kurrikulës së studimeve, e cila ofron njohje të thellë të teorive dhe praktikë ekonomike, përdorim shumë të mirë të metodave sasiore si edhe formim të qëndrueshëm profesional.</p> <p>Programet e studimeve përfshijnë njohuri mbi ekonominë, financën e kontabilitetin, sipërmarrjen, dhe njohuri bujqësore si edhe ato të krijuara praktika profesionale. Programi mundëson gjithashtu aplikimin në praktikë të aftësive të fituara.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>x</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.


Në Manualin e Cilësisë së UBT, 2018 Pjesa V “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë”, Komisioni i Kurrikulës gjykon nëse programi i studimit (i përmirësuar) plotëson kërkesat e Universitetit, është i krahasueshëm me programe të ngjashme të ofruara edhe në vende të tjera apo në Shqipëri dhe nëse kurrikula ofron një përvojë të vlefshme për studentët. Ky komision është i përbërë nga profesorë me përvojë të njësisë kryesore. Gjatë hartimit të procedurave për hartimin, miratimin dhe rishikimin e programit, është e rëndësishme të shqyrtohet:

- ✓ Arsyetimi i zhvillimit të kurrikulave (i justifikuar në bazë të nevojave të tregut (ofertës dhe kërkesës) dhe sfondit të zhvillimit të kurrikulës së mëparshme.
- ✓ Qëllimet dhe objektivat e kurrikulës (përafrimi me misionin kryesor, synimet dhe vizionin e UBT).
- ✓ Strategjitë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- ✓ Strategjia e vlerësimit, duke përfshirë hartimin dhe vendosjen e vlerësimeve.
- ✓ Stafi akademik
- ✓ Syllabusi i kursit / Specifikimi i kursit
- ✓ CV-të e pedagogëve.
- ✓ Strategjia e implementimit


FEA si njësi bazë ka bërë përpjekje për përzgjedhjen e pozicioneve sa më oportune për zhvillimin e praktikave profesionale. Edhe zhvillimi i Panairit të Karrierës ka qenë një mundësi konkrete e kontakteve të drejtpërdrejta të studentëve të viteve të fundit me institucionet publike e private. Në vitet e fundit janë bërë disa marrëveshje ndërmjet UBT dhe subjekteve të ndryshme private e publik të cilat kanë dhënë efekte pozitive.

Nje efekt pozitiv ka edhe ngritja e Grupit Alumni si aktivitet i Qendrës së Karrierës dhe Alumnit.

UBT përditëson në mënyrë të vazhdueshme dhe riorganizon programe në përputhje me vizionin strategjik të zhvillimit të ekonomisë shqiptare në përgjithësi dhe fushës së bujqësisë dhe ekonomisë bujqësore në veçanti. Këto rregullime bëhen në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit të vendit. Këtu është rasti të përmendim angazhimin institucioanal të UBT së bashku me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimin Rural (MBZHR) për hapjen e një




	<p>program të ri ndërdisiplinor në fushën e “Planifikimit të Territorit”, program i cili angazhon dy fakultete të UBT (FEA dhe FBM), si përgjigje e strategjisë kombëtare të Zhvillimit Rural. Në këtë fokus është edhe strukturimi i programit “Ekonomi dhe Politikat Agrare” në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural” në FEA.</p> <p><i>Aneks : “Aneks 48 Raporti i Zyres se Marredhënive me Jashtë_Nëntor 2022. Pika 3/3.1“)</i></p> <p><i>Aneks “Manuali i Cilësisë në UBT, 2018”</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti mban kontakte me student të diplomuar jo vetëm nënrmjet aktiviteteve të ndryshme si konferenca panairë pune etj, me qëllim që ata të japin drejtpërdrejt kontributin e tyre në përmirësimin e programit të studimit. Është praktike normale që gjithnjë studentët e diplomuar të ftohen që të japin eksperiencën dhe opinionin e tyre mbi programin e studimit. Si aktivitet i Qendrës së Karrierës dhe Alumnit është edhe mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me studentët e diplomuar për të siguruar informacion mbi dobishmërinë e studimeve që kanë realizuar e ndjekur në FEA dhe propozimet e tyre lidhur me përmirësimin e mundshëm të programit të studimit.</p> <p>FEA ka njësinë e vet të sigurimit të brendshëm të cilësisë akademike e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Njësia e sigurimit të cilësisë realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga FEA.</p> <p>Institucioni (UBT) inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Në kuadër të procedurës për zhvillimin dhe përmirësimin e programit të studimit procedura e shprehur në Manualin e Cilësisë, parashikon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngritjen e grupeve të punës / komisioni i cili do të merret me zhvillimin e kurrikulave. Në përbërje të komisioneve duhet të ketë edhe studentë nga Këshilli Studentor dhe së paku një përfaqësues nga profesionistët e fushës jashtë universitetit. • Bërjen e analizës SËOT të kurrikulës ekzistuese, kur ekziston një kurrikul paraprake. • Rënien dakord me sugjerimet për kurrikulën nga komisioni. • Miratimin e propozimit nga Komisioni, Departamenti, Dekanati, Rektorati dhe Senati. • Diskutimi i plan programit të ri me institucionin partner, nëse programi i ri do të ofrohet në bashkëpunim me një universitet partner. <p><i>Aneks “Manuali i Cilësisë në UBT, 2018”</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje</p>	<p>Rishikimi, rivlerësimi dhe trajtimi kritik i programeve, syllabuseve dhe planit mesimor është vecori tipike e departamentit që e ofron kete program studimi.</p>



<p>me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Një komponent i rëndësishëm i analizës në këtë proces është edhe kryerja e një vlerësimi të kompetencave të kërkuara nga sektori publik dhe privat i punës dhe nevojave të këtij sektori për profesionistë dhe kompetenca specifike profesionale. Në këtë kontekst është zhvilluar edhe studimi i tregut të punës, që është bazuar në një analizë të dhënave dytësore dhe rreth njëzet intervista me ekspertë dhe përfaqësues të institucioneve publike dhe private që përbëjnë potencial për punësimin e të diplomuarve të programit Bachelor në EPZHR. Ky studim është kryer gjatë vitit 2021 dhe është rifreskuar gjatë vitit 2022.</p> <p><i>Studimi i Tregut të Punës 2022</i></p> <p><i>Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare, 2021, neni 91, pika 1</i></p> <p><i>Rregullore e DVBCS 2021, neni 1</i></p> <p><i>Rregullore e Brendshme e FEA-s, 2017, neni 91, pika 1 dhe 2</i></p> <p><i>Pyetësori i studentëve 2017-2018</i></p> <p><i>Pyetësori i studentëve online 2021</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Neni 20 i Rregullores së FEA-s përcakton se modulet mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në programet e studimit dhe kreditet për secilën prej tyre mund të rishikohen. Ndryshimet i propozohen nga departamenti përkatës duke ndjekur instancat përkatëse deri në miratimin përfundimtar nga Senati Akademik i UBT, në rastin kur masa e ndryshimit të kërkuar nuk e kalon nivelin 20%. DEPZHR-ja ka monitoruar në mënyrë konstante dinamikat e zhvillimit të biznesit përmes së cilave orjenton përmirësimin kurrikular apo çeljen e programeve të reja.</p> <p>UBT harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Universiteti Bujqësor i Tiranës ka njësinë e vet të sigurimit të brendshëm të cilësisë akademike, e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Ngritja e njësisë bëhet sipas legjisacionit në fuqi. Kjo njësi është Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>DEPZHR-ja vlerëson në vazhdimësi programet studimore që ofron, përfshirë edhe programin Bachelor në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rual” bazuar në kërkesat e tregut të punës. Një komponent i rëndësishëm i analizës në këtë proces është edhe kryerja e një vlerësimi të kompetencave të kërkuara nga sektori publik dhe privat i punës dhe nevojave të këtij sektori për profesionistë dhe kompetenca specifike profesionale.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>


<p>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës II</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>
---	-------------------------------------	------------------------------------	-------------------------------------	-----------------



MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënësve, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>IAL e cila ofron këtë program studimi ofron të gjitha kushtet që programet e ofruara të ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Metodatat dhe programet e ofruara janë në përputhje me standardet kombëtare dhe është bazuar dhe në eksperiencat më të mira ndërkombëtare, të cilat stafi akademik i ka fituar në vite.</p> <p>Format e mësimin teoretik dhe praktik janë: leksionet, seminarat, ushtrimet, punët laboratorike, praktikatat mësimore dhe profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit etj. Në përfundim të secilit modul parashikohet zhvillimi i provimit përkatës. Në total për këtë program studimi, për të treja vitet e studimit, orët në auditor janë: Leksione = 915 orë dhe Seminare = 885 orë mësimore në auditor.</p> <p>Ne programin mesimor përfshihen të gjitha format e parashikuara brenda këtij kriteri dhe departamenti përgjegjës kujdeset me se miri ne ofrimin e tyre cilesor.</p> <p><i>Aneks 84. CV e stafit akademik MP</i> <i>Aneks 1 L. 80/2015</i> <i>Rregullore programit të studimit EPZHR 2023</i> <i>Kurrikula e Studimeve Bachelor EPZHR, 2022 – 2023</i> <i>Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare, 2021, neni 50.</i> <i>Analizë Mësimore dhe kërkimore FEA, 2021 - 2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik është i gatshëm të adaptojë metoda të reja në mësimdhënie për t'iu përshtatur diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p> <p>Personeli akademik mund të zhvillojë orët e leksionit apo seminarëve dhe në gjuhën angleze (pjesa më e madhe e stafit) por edhe në një gjuhë tjetër të huaj në varësi të kontigjentëve të studentëve që zhvillojnë studimet në këtë program me kohë të plotë apo për një periudhë të caktuar (studentët që vinë me erasmus kryesisht) duke iu përgjigjur në këtë mënyrë maksimalisht zhvillimit të mësimdhënies në një nivel të lartë profesional. Personeli akademik ka dëshmuar profesionalitet në mësimdhënie dhe në kushte të vështira të zhvillimit të mësimin online.</p> <p>Personeli akademik pranon dhe bën përpjekjet maksimale për të ofruar mundësi dhe metoda gjithëpërfshirëse dhe alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies, nisur dhe nga karakteri profesional që ka programi i studimit. Në procesin e mësimdhënies janë futur teknikat audiovizive të mësimdhënies. Për të bërë të mundur realizimin e këtyre teknikave, në FEA janë ngritur mjedise mësimdhënëse si auditorë të pajisur me kompjutera, retroprojektorë, etj që mundësojnë një aftësim të studentëve në drejtim të shprehive praktike Që në fazën e projektimit të programit të studimit, parashikohen forma të ndryshme të veprimtarive formuese që përmban një disiplinë e caktuar. Nëse shikohen me kujdes këto forma, i jepet shumë rëndësi veprimtarive praktike të formimit, siç janë: ushtrime, detyra, projekte, apo edhe praktika të lëndës</p>

	<p>Qëllimi i tyre është që studenti nëpërmjet këtyre veprimtarive formuese të aftësohet në zbatime praktike të njohurive teorike të dhëna në leksione. Një pjesë e tyre bëhen nën asistencën e detyrueshme të pedagogut, siç janë seminarët, konsultimet, etj, ndërsa një pjesë tjetër zhvillohen si punime të pavarura të studentit nën konsulencën e pedagogut, siç janë detyrat, projektet etj.</p> <p><i>Aneks 83 Syllabuset e programit MP</i> <i>Aneks 66 Infrastruktura e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, viti 2022</i> <i>Analizë Mësimore dhe Kërkimore FEA, 2021-2022.</i> <i>Lista me stafin që ka zhvilluar leksione të hapura</i> <i>Rregullore e programit të studimeve EPZHR, 2023.</i> <i>Rregullore e programit të studimeve EPZHR, 2023</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësit.</p>	<p>Mobiliteti i stafit akademik për qëllime specializimi, në kuadër të marrëveshjeve me institucione arsimore apo qendra kërkimi jashtë vendit dhe integrimi i njohurive dhe eksperiencës së marrë në universitete të huaja në punën e tyre didaktike e mësimore, ka qenë dhe mbetet një tendencë kostante për rritjen e kapaciteteve akademike dhe nivelit të ekspertizës së FEA-s</p> <p>Personeli akademik ndjek periodikisht agjenda për kualifikim në fushën e kërkimit dhe studimit shkencor për të ndikuar në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Pjesëmarrja në projekte kombëtare, rajonale apo ndërkombëtare, ndjekja me prezencë dhe me punime në konferenca, seminare dhe <i>ëorkshop</i>-e apo evente të ndryshme shkencore janë një mundësi konkrete për aktualizimin dhe thellimin e njohurive të fushës së angazhimit, për vendosjen e urave të komunikimit dhe bashkëpunimit të qëndrueshëm me to</p> <p><i>Aneks Trajnime të stafit të brendshëm të FEA, 2021</i> <i>Tabela 5: Institucionet Dhe Organizatat Bashkëpunuese.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Stafi akademik i FEA-s reflekton seriozitet dhe përkushtim në detyrë. Stafi dallohet për kompetencë profesionale (pedagogët zotërojnë njohuri shumë të mira teorike dhe praktike për modulet që mbulojnë shqip dhe në gjuhë të huaj). Një pjesë e konsiderueshme e stafit kanë kryer shkollime/kualifikime/trajnime jashtë dhe reflektojnë dijet dhe praktikat më të mira në arsimin e lartë. Stafi akademik i FEA-s ka aftësi të mira në mësimdhënie. Të gjithë këta faktorë reflektohen tek performanca pozitive e studentëve dhe tek përqindja e kalueshmërisë së tyre vlerat e së cilës janë reflektuar në rubrika të tjera si edhe tek kërkesa në rrijte për të studiuar në programet e studimit të ofruara nga FEA në të gjitha ciklet e studimit.</p> <p>Pedagogët krijojnë raporte të ndërsjella respekti reciprok me studentët, i mbështesin ata në kuadër të formimit të tyre profesional për të qenë sa më të përgatitur në tregun e punës.</p> <p><i>Format Pyetsori Për Vlerësimin e Procesit Mësimor.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Çdo fund viti akademik, njësia kryesore harton dhe shpërndan një pyetësor i cili plotësohet nga studentët. Në të janë përfshirë disa elementë vlerësues: matja dhe vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, materialet mësimore, si dhe vlerësimi i infrastrukturës që ofrohet në këtë program studimi. Në këtë mënyrë studentët përfshihen për të dhënë mendimet dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Ky lloj vlerësimi është bërë edhe gjatë mësimit online</p> <p><i>Aneks Pyetsori online UBT 2019</i> <i>Aneks Format pyetsori për vlerësimin e procesit mësimor, FEA</i></p>



<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Prioritet kryesor i UBT-së mbetet kualifikimi i vazhdueshëm i stafit akademik. Për vitin akademik 2022 – 2023, DEPZHR ka 18 pedagogë nga të cilët janë 2 Prof.Dr; 9 jane Prof.Asoc ku 2 prej të cilëve janë në proces për Prof.Dr; 5 janë me gradën Dr. ; 1 është Dr. Në proces dhe 1 pedagog është Msc.7</p> <p>Stafi i DEPZHR- së është i organizuar në 3 GMK, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre, mësimdhënie, kërkim në katër drjtime të rëndësishme:1. Ekonomitë e Aplikuara; 2. Politikat e Bujqësisë, 3.Mikro-Makroekonomi. Në kuadrin kërkimeve dhe botimeve shkencore në revista vendi dhe të huaja prestigjoze mund të themi se stafi i DEPZHR-së ka arritur rezultate shume te larta si ne botime dhe pjesmarrje në konferenca ndërkombëtare. Kualifikimi shkencor dhe kualifikimi nëpërmjet trajnimeve e ndihmon stafin në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p>Në fund të çdo viti akademik, departamenti përpilon një raport mbi ecurinë mësimore dhe kërkimore ku evidenton pikat e forta dhe nevojat për përmirësim dhe e përcjell në njësinë kryesore e cila e harton raportin e analizës mësimore në nivel fakulteti dhe e përcjell në rektorat. Mbështetur në këto raporte, senati akademik harton raportin e punës mësimore të UBT, të cilën e miraton në një mbledhje të tij. Ky raport së bashku me analizën e punës kërkimore dhe atë financiare përcillen në MASR. Të dhënat e pasqyruara në këtë raport shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme. Ky raport, përcillet tek secili prej anëtarëve të personelit akademik.</p> <p>Në kuadër të zhvillimit të metodave të reja inovative të mësimdhënies, DEPZHR dhe FEA organizojnë leksione të hapura në mënyrë periodike. Gjatë leksioneve të hapura stafi i ri ndjek orë leksionesh nga stafi me përvojë ose mund të asistojë gjatë orëve të hapura nga titullarët e modulit. Në FEA dhe DEPZHR ndiqet gjithashtu dhe praktika e dhënies së leksioneve nga pedagogë të ftuar nga vëndi ose të huaj.</p> <p><i>Rregullore e UBT-së për studimet universitare, 2021, neni 49, neni 93</i> <i>Tabela 2: Personeli i DEPZHR-së</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të mësimdhënies, mësimdhënies dhe të kontrollit të dijeve. Këto forma parashikohen në planet mësimore, programet e moduleve dhe rregulloren mësimore të programit të studimit.</i></p> <p><i>Puna e stafit të FEA-s dhe rezultatet e arritura në vitin akademik 2021-2022 kanë qënë përgjithësisht të kënaqshme në drejtim të mësimdhënies dhe organizimit të tij.</i></p> <p><i>Personeli akademik përmirëson vazhdimisht programet e lëndëve duke alternuar metoda të ndryshme mësimdhënie në përshtatje të nevojave të studentëve.</i></p> <p><i>Universiteti Bujqësor i Tiranës ka mbështetur dhe vazhdon të mbështesë personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike e cila dëshmohet nga marrëveshjet e shumta të bashkëpunimit që ka me institucione homologe si brenda dhe jashtë vendit.</i></p> <p><i>Pedagogët përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies si ato audiovizuale të alternuara me shpjegimin e tyre jo vetëm duke i pasqyruar në dërrasë por edhe duke diskutuar me studentët mbi pyetje të ndryshme të ngritura apo çështje të caktuara në mënyrë që të nxisë aftësinë e të menduarit dhe të të shprehurit të studentëve por edhe për ta bërë orën e mësimi më tërheqëse për ta. Sipas temave të caktuara studentët mund të realizojnë orë të caktuara në kompani apo institucione të ndryshme apo të ftohen pedagogë apo specialistë të fushës</i></p>

⁷ Tabela 2: Personeli i DEPZHR-së

	<p><i>përkatëse. Këto alternime të mësimdhënies ndikojnë në rritjen aftësive të mësimnxënies së studentëve.</i></p> <p><i>Procesi i mësimdhënies është objekt analize në departament, fakultet dhe në senatin akademik. Analiza e procesit mësimor bëhet në përfundim të vitit akademik. Departamenti analizon të gjitha elementët e realizimit të programit mësimor, si mbulimi me materialeve studimore, realizimi i formave të kontrollit të vazhdueshëm dhe provimit përfundimtar të lëndëve, realizimi i praktikave profesionale, realizimi i punimeve të diplomave dhe nëse e vlerëson të arsyeshme propozon ndryshime.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kontrolli i dijeve shërben për të vlerësuar progresin e studentit gjatë periudhës së studimit në auditor dhe studimit individual, në përvetësimin e dijeve dhe për të matur aftësinë e tij profesionale të fituara gjatë ndjekjes së lëndës/modulit. Kontrolli i dijeve për çdo modul bëhet nëpërmjet vlerësimit të punimit dhe prezantimit të detyrave të kursit, punëve në grup, kolegiumeve, pjesëmarrjes dhe aktivizimit në seminare si dhe provimi përfundimtar.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> <p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Ekziston nje procedure e mirepercaktuar ku cdo student gjatë prezantimit me modulën dhe pedagogun/un përkatës, merr prej saj/tij që në ditën e parë informacion të plotë rreth metodologjisë së kontrollit të njohurive, dijeve, aftësive si dhe kompetencave të tij.</p> <p>Studenti njihet me frekuencën e testimit gjatë vitit dhe merr informacion për formën e provimit përfundimtar (me shkrim apo me gojë); numrin e kontrolleve ndërmjetëse që do të realizohen gjatë vitit, të parashikuara në planin kalendar, tema të detyrave të kursit etj.</p> <p>Gjithashtu, studentëve u tregohet qartësisht mënyra e sigurimit të literaturës (tekst në shitje, skript leksionesh, shënime në klasë, literaturë e huaj, etj. Një listë e literaturës shtesë dhe të huaj është e listuar në syllabusin e modulit, të cilin pedagogu i lëndës ua vendos në dispozicion studentëve në fillim të vitit akademik.</p> <p>Në këtë syllabus ka të dhëna dhe mbi mënyrën e vlerësimit të studentit, testimet e ndërmjetme, etj.</p> <p>Testimet e njohurive behen permes rubrikave:</p> <ul style="list-style-type: none"> - testimi i ndërmjetëm, - aktivizimi në seminare, - realizimi i projekt kursit ose i detyrës së kursit dhe - provimi final. <p>Mënyrat e kontrollit të dijeve përcaktohen në programin e modulit dhe planin mësimor të studimeve të cilat i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor.</p> <p>Testimi i dijeve dhe aftësive profesionale vlerësohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. Në Rregulloren e Studimeve</p>

	<p>Universitare, UBT, kreu IX, neni 56, shprehet qartë mënyra e vlerësimit të studentit gjatë ndjekjes së programit të studimit. Kjo ndarje respektohet shumë mirë dhe paraqitet në Syllabuset e çdo moduli, në seksionin Elementet e Vlerësimit dhe në Planet Mësimore.</p> <p><i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural", 2023.</i></p> <p><i>Rregullore FEA, 2017</i></p> <p><i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural", 2023.</i></p> <p><i>Aneks Syllabuset e programit</i></p>		
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga një bashkëpunim me AADF dhe projektin CleanScore, pedagogët dhe studentët kanë përfituar korrigjim automatik të testimeve të provimeve, duke përshpejtuar procesin e korrigjimeve dhe publikimin e tyre në kohë rekord, duke bërë transparent procesin e korrigjimit dhe duke shmangur cdo formë abuzimi ndaj studentëve apo ankesë të studentëve lidhur me notat.</p> <p>Me qëllim që të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme puna mësimore, departamenti organizon vlerësimin e brendshëm të procesit mësimor nëpërmjet anketimeve. Ky proces përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimin e procesit të mësimdhënies - Formatin tip i anketës miratohet në departament dhe organet drejtuese të UBT-së. - Zbatimi i vrojtimit dhe analiza kryhen në bashkëpunim të ngushtë me strukturat drejtuese të FEA-s dhe UBT-së. <p>Përdorimi i metodave të shumëllojshme pedagogjike si metoda praktike, vizuale, verbale etj, mundësohen nga institucioni në mënyrë që të arrihen rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësit.</p>		
Konkluzione	<p>Njësia kryesore/bazë, ka hartuar rregullore të qarta ku shprehet mënyra e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në	Format e kontrollit të dijeve përcaktohen në mënyrë shumë të qartë në disa prej rregulloreve, si në nenin 56 dhe 57 të Rregullores së studimeve të UBT, në rregulloren e brendshme të FEAs neni 55, dhe neni 17 në rregulloren e programit të studimit. Sipas rregullores dhe praktikës që aplikohet në këtë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>program studimi Bachelor, testimi e vlerësimi I njohurive paraqitet në pikat si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi I studentit ndahet në dy pjesë, ai I vazhduar që përfaqëson 30-50% të vlerësimit total dhe ai final. • Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një moduli janë: aktivizimet në orët e seminareve, testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, projektet apo detyrat e kursit, esetë dhe provimi final. Detyrat e kontrollit janë elementë të vlerësimit të vazhduar të nivelit të dijeve. • Mënyrat e kontrollit të dijeve dhe përcaktimi i raporteve midis dy llojeve të vlerësimit, përcaktohen në programin e modulit dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor. <p>Në fillim të çdo moduli të programit të studimeve Bachelor në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural”, pedagogu njih studentët me programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit të njohurive dhe literaturën, që do të përdoret në modulën përkatës. Gjithashtu syllabuset janë ndërtuar sipas modelit të VKM 41 dhe përmbajnë mënyrën e vlerësimit të vazhduar dhe final, në seksionin “Forma e kontrollit të dijeve”.</p> <p><i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural”, 2023.</i> <i>Rregullore FEA, 2017</i> <i>Aneks Syllabuset e programit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Sa përket sistemeve të testimit, institucioni ka marrëveshje me AADF dhe ka përdorur sistemin e CLEANSORE për të garantuar që provimet në disa pjesë të tyre të shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe të rritet transparenca. Sa u përket sistemeve elektronike të vlerësimit final ato janë në proces ndërtimi, për të krijuar një sistem të përgjithshëm të mbledhjes dhe evidentimit të vlerësimeve të ndryshme dhe vlerësimit total.</p> <p>Evidenca: Vizita në institucion, takimi me drejtuesit dhe pedagogët e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Studenteve që në orët e para të leksioneve ju bëhet me dije struktura e lëndës më përqindjet në vlerësimet, ku dallojnë dy zërat kryesor: ai i vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimi përfundimtar me provimin përmblyllës. Kjo masë vlerësimi është përcaktuar në rregulloren e programit të studimit</p> <p>Kontrolli i dijeve gjatë procesit mësimor merr në konsideratë: pjesëmarrjen dhe angazhimin e studentit në leksione, seminare, ushtrime, punë laborator, detyra me shkrim (provime ndërmjetëse), detyra kursi, projekte kursi, praktika mësimore, etj. Në lidhje me disa pika të rregulloreve përkatëse për provimin final:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ai mund të organizohet me shkrim, me gojë ose në një formë të kombinuar (me shkrim e me gojë). Në rast të provimit të kombinuar, departamenti përcakton nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eliminuese.



	<ul style="list-style-type: none"> ai organizohet dhe përfundon në datën dhe orarin e përcaktuar në grafikun e provimeve. Grafiku i provimeve hartohet nga Zv/Dekani për mësimin në bashkëpunim me përgjegjësat e departamenteve dhe miratohet nga Dekani. Grafikët e provimeve shpallen jo më vonë se katër javë para fillimit të sezonit. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Tezat e provimit hartohen nga titullari i modulit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet ndërrimi i tezës. <p>Baza ligjore në fuqi për vlerësimin final i cili merret bazuar mbi vlerësimin e vazhduar dhe atë të provimit final, është VKM 41, që përcakton edhe strukturën e syllabusit së bashku me një kuadër të vlerësimit të studeñtit.</p> <p><i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural”, 2023.</i> <i>Rregullore FEA, 2017</i> <i>Rregullore e UBT për studimet universitare 2021</i> <i>Syllabuset e programit</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në rregulloren e brendshme të FEA, neni 72, pikat 1 dhe 2 parqesin edhe mënyrën se si pedagogët duhet të japin feedback dhe komente lidhur me vlerësimet, përkatësisht me shënime në rastin e detyrave dhe provimeve të pjesshme, ndërsa në rastin e provimeve finale, pas shpalljes së rezultateve në sistem, studenti ka të drejtë të kontestojë rezultatin brenda 48 orëve, duke marrë shpjegime dhe qartësime prej komisionit duke ballafaquar përgjigjet e studentit me përgjigjet e tezës. Pas ballafaqimit rregullorja i jep te drejtë komisionit të mbyllë notën përfundimtare të provimit në sistem.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p><i>Sipas rregulloreve, njësia përgjegjëse përcakton një komision me dy anëtarë ndër të cilët kryesor është titullari i lëndës, me miratim të përgjegjësit të departamentit. Rregullore e UBT për studimet universitare përcakton se studentët nuk mund të hyjnë në provim pa mjet identifikimi dhe gjithashtu detyrohen të mos kenë asnjë mjet elektronik me vete, duke u përjashtuar nga provimi nëse nuk zbatojnë rregullat për moskopjim. Lidhur me temat detyrat dhe projektet nuk lejohet plagjiatura.</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p><i>Rezultatet e kontrollit të dijeve bazohen në meritë, pasi procesi i vlerësimit është i mirëpërcaktuar dhe çdo metodë vlerësimi kontribuon në vlerësimin final me pikë dhe me notë. Kategorizimi i pikëve me notë përcaktohet në syllabus dhe në rregullore. Rezultatet jepen brenda 48 orëve kur provimi është me gojë dhe brenda 8 ditëve kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe me gojë. Më pas rregullorja përcakton edhe afatet e ankimit dhe dhënien e përgjigjeve finale.</i></p> <p><i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural”, 2023.</i> <i>Rregullore FEA, 2017</i> <i>Rregullore e UBT për studimet universitare 2021</i> <i>Syllabuset e programit</i></p>



<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në rregulloret e programit të studimit, rregulloren e FEA dhe rregulloren e UBT për studimet univeritare, neni 65, studentët kanë të drejtë për tu njohur me vlerësimin si dhe për ta kundërshtuar Brenda një afati prej 48 orësh, duke kërkuar rishikim të rezultatit. Pasi ballafaqohet me komisionin e provimit I cili ka detyrimin të sqarojë studentin, rezultati final I rishikuar ose jo, sipas vendimit, pasqyrohet në sistem. Nga data e provimit, pasi kalojnë 12 ditë, sistemi nuk gjeneron më procesverbal, pra gjithë procedurat duhet të jenë të përfunduara.</p> <p>Procedura e ndjekur është tepër transparente pasi palët mbajnë të dhëna për procesin e vlerësimit dhe rishikimit dhe dërgojnë në department vlerësimin e rishikuar. Neni 24 I rregullores së programit të studimit lidhet pikërisht me ankimimet dhe procedure që do të ndiqet.</p> <p><i>Rregullore FEA, 2017</i> <i>Rregullore e UBT për studimet universitare 2021</i> <i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural", 2023.</i></p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Shkalla e përmbushjes së standardit, është përmbushje plotësisht, duke qenë se të gjitha rregulloret në nivel universtar, në nivel fakulteti dhe në nivel programi studimi përmbajnë rregullat e duhura për vlerësimin e studentëve në mënyrë korrekte dhe duke pasqyruar dijet e plota të studentit. Gjithashtu ato përmbajnë procedura të qarta për procesin e ankimimit dhe transparencën e këtij procesi, duke ndikuar në rritjen e besueshmërisë e si rrjedhim cilësinë e programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion GVJ gjithashtu u siguroa për mes pyetjeve të studentëve që këto procedura po ndiqen në mënyrën e duhur, gjë që e garanton edhe eksperiencia afatgjatë institucionale, por edhe e departamentit.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="595 1171 794 1227">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="794 1171 994 1227">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="994 1171 1193 1227">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="595 1227 794 1272"></td> <td data-bbox="794 1227 994 1272"></td> <td data-bbox="994 1227 1193 1272">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi III.4


Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi I studimit ka objektiva të qarta të lidhura me formimin e studentëve në aftësitë dhe kompetencat profesionale, këto janë shprehur në kurrikulën e studimeve bachelor. Gjithashtu nga të dhënat për studentët dhe studimi i tregut tregon që studentet e kane gjetur veten në punësim dhe karriere kryesisht në biznesin rural dhe aktivitete të lidhura kjo është konsideruar positive përmes kurrikulave ku gjenden module që furnizojne me njohuri, aftesi dhe kompetenca duke vlerësuar përmes gjurmimit të studenteve pas diplomimit.</p> <p>Programi I studimit ka krijuar kompetenca në fusha të përshtatshme në mënyrë që diplomimi i studentëve të lëjë hapësirë dhe shteg për profilizime apo trajnime të tjera të mëtejshme, si në rastin e lëndëve Ekonomia e burimeve natyrore dhe ambientit, Zhvillimi rural i QEndrueshëm, Ekonomia Agrorëshqimore, etj..</p> <p>Një ndër strategjitë e institucionit, në funksion të ritjes së aftësive krijuese të studentit por edhe testimit të identifikimit të të gjitha aftësive të tij, është edhe sistemi i vlerësimit përmes vlerësimit të vazhduar, duke krijuar mundësi për</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p>vlerësimin e aftësive të buta si aftësitë krijuese të studentit, mendimi kritik, komunikim dhe bashkëveprim, njohuri dhe kapacitete për zgjidhjen e problemeve, etj. Programi krijon aftësi dhe kapacitete për të punuar sinë sektorin privat ashtu edhe në atë public të lidhur me ekonominë rurale dhe agrare.</p> <p><i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural", 2023.</i> <i>Kurrikula e studimeve bachelor EPZHR 2022-2023</i> <i>Syllabuset e kurseve të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Aftësitë e vecanta në fushën e Teknologjisë së informacionit, jepen nga lëndët të formimit si informatika, sem 4. Ndërsa aftësitë në fushën humane, sociale, e komunikim jepen nga lëndët Socilogji, Semestri 1, Komunikim, Semestri 2, Marketing semestri 3, Integrim evropjan apo Demografi semestri 5 dhe 6.</p> <p><i>Evidenca</i> <i>Kurrikula e programit të studimit</i> <i>Struktura mësimore</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblylëse.</p> <p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i</p>	<p>Në përfundim të lëndës, kapacitetet dhe aftësitë e fituara të studentit vlerësohen përmes formave të ndryshme të vlerësimit të dijes.</p> <p>Kompetencat që fiton studenti janë të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde dhe të analizuarat përtej analizave e shqyrtimit në përfundim të çdo lënde, apo përtej analizave periodike e vjetore, edhe gjatë vizitës në terren janë të diskutuara edhe me përgjegjesin e departamentit apo me njeri tjetrin. Ato ndikojnë për të rritur cilësinë e kurrikulës duke qenë i ndërgjegjshëm me sfiden me të cilën është perballur në kaq pak vite që kur është hedhur në treg.</p> <p>Në syllabuset e çdo lënde studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulin përkatës.</p> <p>Në javën e fundit të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Njëkohësisht, merret edhe feedback nga ana e studenteve lidhur me objektivat e vendosura për këtë qëllim.</p> <p>Në javën e fundit të semestrit studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final.</p> <p>Në lidhje me aspektin e zbatimit të njohurive dhe kompetencave të marra, kryesisht stafi akademik gjatë procesit të mësimdhënies nxit punën e studentit në dy aspekte: së pari gjatë seminareve me diskutime dhe detyra, trajtim të rasteve të studimit dhe ushtrimeve dhe së dyti nëpërmjet projekteve të kursit të cilat janë të vendosura në zbatimin e njohurive në kompani po ndërmarrje specifike. Gjatë takimeve në institucion kryesisht takimi me pedagogët e programit u diskutuan disa shembuj të ngritjes së kompetencave të studentit si puna në grup, komunikimi dhe zbatimi i njohurive, përgjithësimi i rezultateve etj., përmes realizimit të projekteve konkrete të kursit. Ndërkohë praktika profesionale përfshihet në kurrikul në një semestër të plotë. Kështu krijohet</p>

<p>mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>edhe klima e përshtatshme për zhvillimin e ideve innovative dhe ndërthuren format e ndryshme të mësimdhënies duke rritur aftësitë praktike të studentëve. Sa u përket mobiliteteve UBT ka 140 marrëveshje active dhe lejon patjetër mobilitetet e studentëve, duke i nxitur ata të marrin pjesë në shkëmbimet Erasmus plus që janë të mundshme. Por ka një numër të ulët të studentëve të angazhuar në këto mobilitete dhe nga ky program studimi nuk ka student të përfshirë në mobilitete.</p> <p><i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural", 2023.</i> <i>Kurrikula e studimeve bachelor EPZHR 2022-2023</i> <i>Syllabuset e kurseve të programit të studimit</i> <i>Zyra Erasmus UBT, DRejtorja e projekteve dhe e zhvillimit 21-22</i> <i>Vizita në institucion, takimi me pedagogët e programit</i></p>		
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Gjithë personeli akademik I programit të studimit është I angazhuar për të zbatuar disa risi lidhur me procesin e mësimdhënies, ku përfshihen edhe ftesa e lektorëve, sidomos nga ana e industrisë dhe agro-biznesit. Kryesisht në lëndë aplikative si ekonomia e burimeve natyrore, politikat e bujqësisë dhe ushqimit, etj ka mundësi të realizohen orë të hapura dhe janë realizuar disa orë pranë biznesit, bazuar në diskutimet me stafin e programit, por ende më zyrtarisht duhet të realizohet procesi I këtyre orëve dhe metodave.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me pedagogët e programit</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Shkalla e përmbushjes së standardit, është e plotë për shkak të kurrikulës e cila përfshin lëndët dhe modulet e duhura për krijimin e aftësive dhe kapaciteteve të studentëve lidhur me ekonominë dhe zhvillimin e politikave rurale. Nga ana tjetër kësaj kurrikule I shtohen dhe përpjekjet e stafit për të realizuar aktivitete dhe angazhuar studentët që me aktivitetet poaktike të aplikojnë njohuritë duke rritur kapacitetet e tyre në profesion.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi III.5


Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p> <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë</p>	<p>Brenda një muaj nga dita e fillimit të vitit akademik, departamentet u bëjnë të njohur studentëve të vitit të fundit programet e provimit të formimit nëpërmjet Sekretarisë Mësimore dhe asaj të DMTR dhe informon studentët rreth organizimit të provimeve të formimit. Studentët diplomohen me temë diplomënëse kanë një notë mesatare më të lartë se 8 dhe kjo përcaktohet në rregulloren e brendshme të FEA neni 28 pika 7. Standartet dhe kriteret për punimin e diplomës përcaktohen nga departamenti</p> <p>Departamenti, në bazë të mundësive të tyre për udhëheqje dhe në përputhje me natyrën e fushës së studimit, listojnë studentët që planifikohen të diplomohen</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p> <p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>nëpërmjet mbrojtjes me punim diplome. Temat e diplomës udhëhiqen nga punonjësit mësimor-shkencor të departamentit, sqë kanë titull ose gradë shkencore (së paku Master), nga punonjësit shkencorë të instituteve kërkimore, që i përshtaten studimeve në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe që kanë kualifikim të lartë, si dhe nga shkencëtarë të huaj të fushës përkatëse të diplomimit. Si rrjedhim, pedagogët udhëheqës krijojnë një strukturë komunikimi me studentin dhe u vënë gjatë procesit të mentorimit në dispozicion materiale dhe udhëzimet e nevojshme për të realizuar temën si një nga detyrimet kryesore përmbyllëse të studentit.</p> <p>Sa i përket programit të temave për provimin final ai u vihet në dispozicion studentëve duke u botuar edhe në faqen e internetit sipas programeve të studimit, pas një procedure propozimi nga stafi I njësisë bazë dhe miratimi nga përgjegjësi I departamentit dhe Dekani I FEA.</p> <p>Komisioni I posaçëm I ngritur për qëllimin e mbrojtjes së provimit final të diplomës përbëhet nga stafi departamentit dhe kryetar përgjithësisht përgjegjës in e departamentit. Teza e provimit që u jepet studentëve përmban pyetje nga fondi I krijuar dhe I shpallur publisht duke përfshirë një shumëllojshëmri fushash të studimeve akademike bachelor.</p> <p><i>Rregullore FEA, 2017, neni 28</i> <i>Rregullore e UBT për studimet universitare 2021, neni 27</i> <i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural”, 2023, neni 37.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p> <p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Ndërtimi I listës së udhëheqësve bazuar në kapacitetet për ofrimin e njohurive edhe praktike, perben edhe nje menyre per te integruar stafin e brendshem me eksperiencen e stafit të jashtëm, si dhe dhënien e mundësive që studentët të realizojnë një kërkim në biznese aktuale shqiptare duke pasuruar biblioteken e departamentit por edhe duke vijezuar mbeshtetjen qe departamenti i ben biznesit vendas në çështje të agro-biznesit, ekonomisë dhe politikave rurale, mjedisit të lidhura me to, etj. Mbështetja për realizimin e studimeve bazuar mbi të dhëna nga biznesi jepet në mënyrë të pakushtëzuar duke shfrytëzuar marrëdhëniet e vendosura akademi-biznes prej shumëvitesh tashmë. Duke ndjekur procesin e temës, sipas rregullores së programit të studimit, udhëheqësi dhe komisionet e vlerësimit garantojnë miratimin e punimit sipas standarteve si dhe paraqitjen pranë komisionit final për mbrojtje.</p> <p>Gjithashtu njësia bazë mbështet studentët për realizimin e temave lidhur me matjet përkatëse duke vënë në dispozicion laboratorët për analiza dhe përpunime të dhënash.</p> <p><i>Rregullore FEA, 2017, neni 28, 8</i> <i>Rregullore e UBT për studimet universitare 2021, neni 27</i> <i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural”, 2023, neni 37.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Studenti vlerësohet për provimin e diplomës me notë nga komisioni i diplomës i cili përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë. Senati akademik miraton modelin e temës së diplomës për studentët që do të diplomohen me temë.</p>

<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> <p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Pas marrjes së vlerësimit përfundimtar, studenti përfundon studimet dhe ka të drejtë të diplomohet duke u pajisur me diplomën dhe suplementin e diplomës, listën e notave, sic është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Sipas kërkesave të studentit, në përfundim ai ka të drejtë të marrë një kopje të plotë të të gjithë progrmit të studimit të zhvilluar gjithashtu të shoqëruar sipas kërkesave me syllabuset e programit të studimit.</p> <p>Kopje të dokumentacionit të studentit janë të ruajtura pranë institucionit sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të brendshme të institucionit, departamentit dhe programit të studimit.</p> <p><i>Rregullore FEA, 2017, neni 28 dhe 39</i> <i>Rregullore e UBT për studimet universitare 2021, neni 88 dhe 89</i> <i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në "Ekonomi dhe Politikë dhe Zhvillimit Rural", 2023, neni 38 dhe 42</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Shkalla e përbushjes së standardit është përbushje plotësisht pasi gjithë procedurat e detyrimeve përmblylëse janë parashikuar në rregulloren e institucionit dhe gjithashtu zbatohen nga departamenti dhe stafi i programit në mënyrë rigorozë.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht X</p>	

<p>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht X</p>	
---	-----------------------------	----------------------------	--	--


IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin</p>	<p>Kërkesat ligjore në fuqi për stafin akademik përcaktohen me ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë". Në zbatim të tij si dhe të Statutit të UBT e Rregullores së Brendshme të FEAs, përbërja e stafit akademik është e tillë që përmban staf me titullin minimal Master shkencor.</p> <p>Aktualisht numri i stafit akademik i departamentit DEPZHR, është 18 pedagogë, nga të cilët 2 me gradën Prof. Dr, 9 me gradën Prof. ASoc, 5 me gradën Dr , një Dr në process dhe një me gradën Msc. Ndërsa gjithë stafi i programit të studimit përbëhet nga 34 veta, personel akademik me kohë të plotë dhe me kontratë nga ku 26 janë me kohë të plotë dhe 8 janë me kontratë. Informacion më i detajuar mbi titujt dhe gradat shkencore gjendet në tabelën 7 të anekseve mbi stafin akademik. Stafi i programit I përbush kriteret ligjore</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>për ekspertizën në fushën kërkimore dhe eksperiencën praktike lidhur me programin e studimit.</p> <p>Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit janë pjesë e rregullores së Drejtorisë së burimeve njerëzore. Një element i rëndësishëm përgjatë procedurës është përcaktimi i kritereve të rekrutimit ku një rol të rëndësishëm luan komunikimi me departamentin dhe dekanatin përkatës, sipas intervistës me drejtorin e burimeve njerëzore. Ndërsa kriteret e përgjithshme përcaktohen nga Senati i Institucionit, kriteret e vecanta përcaktohen nga njësia bazë, sipas nevojave të saj për staf akademik dhe miratohen nga Rektori. Në rastet kur ka kritere të vecanta ato lidhen kryesisht me kualifikimet e mëtejshme, eksperiencën Brenda e jashtë vendit dhe sidomos të lidhur me pozicionin vacant, lëndët apo modulet e pambuluara dhe detyrat lidhur me programin specific. (Aneks 79 kriteret e vlerësimit të kandidatëve të punësimit UBT).</p> <p><i>Statuti I UBT</i> <i>Rregullore e brendshme e FEAs</i> <i>Rregullore e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve njerëzore dhe Pagave, 2018</i> <i>Tabela 7, Anekse. Të dhëna përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa e stafit akademi përgatitet në çdo fillim viti akademik nga DEpartamenti dhe përgjegjësi I departamentit duke u bazuar në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Udhëzimet e MAS. Ngarkesa propozohet nga DEPSHR dhe miratohet nga Senati Akademik. PErsoneli akademik efektiv mbulon pothuajse 70% të ngarkesës. Ngarkesa e stafit përcaktohet bazuar mbi titujt akademikë dhe gjithashtu udhëzimet dhe rregulloret për orët e zhvilluara mbi normë, të cilat nuk mund të jenë më shumë se 200 orë dhe në raste të vecanta me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe miratim të drejtuesit të njësisë kryesore, mund të jetë edhe 100 orë më tepër.</p> <p>Gjatë vitit 2022-2023 rekrutimi I dy staf akademik në pozicionin pedagog dhe asistent pedagog, ka mundësuar uljen e orëve të mbuluara nga staf jashtëm i departamentit.</p> <p><i>Statuti I UBT</i> <i>Rregullore e brendshme e FEAs</i> <i>Rregullore e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve njerëzore dhe Pagave, 2018</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Stafi i departamentit dhe i programit të studimit është i qëndrueshëm, për disa vite, përveç dy rasteve të daljes në pension të stafit akademik dhe largimit të tyre sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Ata janë zevendësuar me staf përkatës sipas rregullores së burimeve njerëzore dhe statutit të UBT. Gjithë stafi akademik është I punësuar me kontratë të përhershme ose të përkohshme sipas kategorive dhe kushteve të departamentit dhe programit të studimit.</p> <p>Fondet buxhetore për pagat menaxhohen nga përgjegjësi i sektorit të pagave dhe bursave. Përllogaritja e pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë bëhet bazuar mbi VKM përkatëse dhe gjithashtu deklarohen online të gjitha kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve.</p>



	<p><i>Rregullore për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës dhe administrative, UBT 2018</i></p> <p><i>Rregullore e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve njerëzore dhe Pagave, 2018</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>UBT ka hartuar “Rregulloren për Rekrutimin e stafit akademik ndihmës dhe administrative në UBT”, e cila bazohet në Ligjin 80/2015 për ARsimin e Lartë, Kodin e Punës në RSH, statutin dhe rregulloren e UBT.</p> <p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore ndjek gjithë procedurat për plotësimin e vendeve vakante në strukturë me rekrutimet. Procedura e verifikuar nga dokumentacionet mbështetëse dhe nga vizita në institucion përfshin disa hapa të rëndësishme që nga shpallja e vendit vakant në APP, hartimi i ofertës së punës, kriteret e pranimit, ngritja e komisioneve, vlerësimi i dosjeve, zhvillimi i konkursit, informacioni përfundimtar dhe vendimi i emërimit.</p> <p>Procedurat, afatet e dorëzimit të dokumentacionit, procedura e konkurrimit, rezultatet, afatet e ankimimit janë objekt i rregullores rregullorja për rekrutimin e stafit UBT.</p> <p><i>Rregullore për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës dhe administrative, UBT 2018</i></p> <p><i>Rregullore e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve njerëzore dhe Pagave, 2018</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në statutin e UBT, nenet 1, 2 dhe 3, përcaktohen kategoritë e personelit ndihmës akademik si me karakter mësimor/shkencor dhe ndihmës akademik administrative. Personeli ndihmës akademik i angazhuar në DEPSHR dhe përkatësisht në këtë program studimi është një dhe është personel ndihmës akademik administrativ, specialist. Ai ka përgjegjësinë për mbështetjen e stafit akademik në funksion të programit të studimit.</p> <p><i>Statuti I UBT</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takim me Drejtuesin e Departamentit.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Dokumentacioni lidhur me personelin e institucionit, përfshirë personelin akademik dhe atë mbështetës menaxhohet nga drejtoria e menaxhimit të dokumentacionit personal të punonjësve dhe regjistrave themeltar. Drejtoria e Burimeve njerëzore menaxhon dosjet personale të të gjithë punonjësve, duke përfshirë ata me kontratë të përhershme efektive dhe ata me kontratë të përkohshme të personelit të jashtëm. Dosja përmban dokumentacionin personal të çdo punonjësi, librezën e punës dhe ndryshimet në dosje për shkak të zhvillimit të karrierës dëshmitë e kualifikimeve të mëtejshme të stafit. Nga vizita në zyrën e burimeve njerëzore, u evidentuan mbajtja e të dhënave dhe dosjeve me të gjithë elementët, duke bërë një përzgjedhje me dy anëtarë të stafit dhe u pa saktësia e mbajtjes së informacionit për stafin. Drejtoria e burimeve njerëzore është përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit të përditësuar për secilin anëtar të stafit. Ndërkohë sipas rregullores së studimeve për programin e studimit EPZHR, të gjitha të dhënat për programin e studimit , ndarjen e ngarkesave për stafin dhe të dhëna për përgjegjësin e departamentit mbahen në departament si dhe në dekanat.</p>

	<p><i>Rregullore e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve njerëzore dhe Pagave, 2018</i></p> <p><i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural”, 2023</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli përgjegjës për praktikën profesionale, është personel i departamentit DEPZHR, I cili garanton një proces të praktikave, të mbështetur nga marrëveshjet me organizata të biznesit dhe administratës publike, në nivele vendore e qendrore. Procesi ndiqet nga pedagogët e përcaktuar dhe procedurat janë të mirëpërcaktuara në rregulloren përkatëse. Realizohet një kontratë midis studentit dhe kompanisë/organizatës, institucioni (departamenti, komisioni) marrin përsipër garantimin e vendit të realizimit të praktikës, në rastet kur nuk përcaktohet me dëshirën e studentit. Studentët pas periudhës së ndjekjes së praktikës, sjellin në institucion vërtetimin nga kompania/organizata dhe komisioni i praktikës merr në provimin e praktikës studentët, duke nxjerrë listën e notave. Dokumentacioni gjithashtu paraqet listën e studentëve dhe kompanive/organizatave ku ata do të realizojnë praktikën për cdo vit.</p> <p>Në përfundim të studimeve realizohet punimi i diplomës, ku vendoset në dispozicion personeli akademik udhëheqës i diplomës, zakonisht brenda departamentit ose dhe nga jashtë departamentit nëse vlerësohet e nevojshme, sigurisht me titujt dhe kualifikimet përkatëse. Por vitet e fundit nuk ka qenë nevoja e angazhimit të stafëve akademike shtesë.</p> <p>Zhvillimi i praktikave profesionale mbështetet nga departamenti dhe fakulteti nëpërmjet marrëveshjes me 58 ndërmarrje, 2 organizata dhe 2 institucione, duke garantuar realizimin e praktikës mësimore në mjediset e kompanive/organizatave përkatëse. Për këtë realizohet një marrëveshje e qartë me institucionet që i garanton studentit vendosjen në mjediset e kompanive/organizatave përgjatë gjithë periudhës së praktikës. Departamenti mban marrëdhënie edhe me zyrën Alumni dhe karrierës për identifikimin e kompanive që mund të jenë pjesë e listës për praktika mësimore. Është me rëndësi të theksohet se departamenti është përgjegjës për përcaktimin e vendit të praktikës, duke përfshirë dhe mjediset. Edhe në rastet kur student përzgjedh vetë vendin e praktikës, DEPZHR verifikon subjektin dhe fakulteti lidh marrëveshje bashkëpunimi me të. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e studentit dhe udhëheqësit të praktikës janë të shprehura në rregulloren përkatëse.</p> <p><i>Rregullore e Studimeve për Ciklin e parë të Studimeve Bachelor në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural”, 2023</i></p> <p><i>Tabela 5, Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese</i></p> <p><i>Rregullore e Brendshme e FEA, 2017</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, jo vetëm është përcaktuar që të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës, por edhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. Kështu në përfundim të praktikës mësimore personeli mbikqyrës përpilon një relacion mbi punën e kryer nga studenti dhe vlerëson ecurinë e tij në periudhën që ai ka kaluar pranë ndërmarrjes / kompanisë. Studenti ka për detyrë të ndjekë të gjitha rregullat në institucionin pritës dhe</p>

	në fund të periudhës realizon relacionin e praktikës, I cili së bashku me gjithë dokumentacionin nga kompania, do të vlerësohet nga komisioni Aed-Hoc i ngritur për këtë qëllim.			
	<i>Rregullore e Brendshme e FEA, 2017</i>			
Konkluzione	<i>Shkalla e përbushjes së standardit, është përbushje plotësisht, duke qenë se programi i studimit realizohet nga një department me përvojë Brenda FEA si dhe ka përdorur me titujt dhe gradat si dhe eksperiencën e duhur për të mbështetur proceset e mësimdhënies, kërkimit shkencor si edhe të gjitha procedurat e studentëve deri në diplomim si mbrojtjet e praktikave dhe diplomave. Rregulloret përkatëse janë të qarta dhe të mirëzbatuara lidhur me të gjitha pikat më sipër.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Ambjentet e FEA janë në dispozicion të të gjithë studentëve dhe pedagogëve të fakultetit e si rrjedhim edhe të studentëve të programit EPZHR. Ambjentet fizike vendosen në dy godina me salla leksionesh seminaresh dhe laboratorë për zhvillimin e lëndëve aplikative si Informatikë , Ekonometri, kontabiliteti etj. Godinat kanë në dispozicion të FEA 14 salla leksionesh, 26 salla seminari , 4 laboratorë informatike dhe 3 laboratorë për lëndë specifike të fushës së ekonomisë, 2 salla për praktika lëndore profesionale si dhe një sallë për aktivitete promovuese. Studentët dhe pedagogët kanë akses në dy ambiente bibliotekë, Ajo e Universitetit dhe ajo e FEA, ku hapësirat janë të bollshme dhe ka student që e frekuentojnë (vizita në institucion). Tabela 16 të dhëna për infrastrukturën dhe mjediset e FEA Relacion për realizimin e buxhetit 2021 dhe planifikim 2022 FEA
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Çdo sallë e leksioneve në godinën B është pajisur me videoprojektor dhe disa janë pajisur edhe me laptop. Ndërsa në Godinën A, e cila është në process rikonstruksioni, disa salla janë pajisur me videoprojektor ndërkohë që ka videoprojektor në department I cili përdoret në këto raste, sipas planifikimit të orëve. Për çdo leksion mundësohet pra prezantimi PPT. Laboratorët janë të pajisur me një numër të konsiderueshëm kompjuterash duke patur parasys grupet e studentëve. Pajisjet janë të reja në dy prej laboratorëve dhe situata është relativisht e kenaqshme për realizimin e orëve laboratorike. Në laboratorë mungon videoprojektori apo pajisje që do ta bënin mësimin më ndërveprues dhe funksional në to.

<i>Tabela 16 të dhëna për infrastrukturën dhe mjediset e FEA</i>							
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Sipas vizitave në institucion dhe në strukturat e FEA, u pa se laboratorët janë të përshtatur për realizimin e orëve të informatikës, financë, kontabilitet, ekonometri, duke patur mundësi të Softwareve përkatës aplikativë për realizimin me rigozitet të programit të këtyre lëndëve.</p> <p>Gjithashtu është në funksion salla e konferencave, dhe Salla “GETE për aktivitete promovuese në FEA, dhe si rrjedhim edhe në funksion të këtij programi studimi.</p> <p>Anketimet e studentëve kanë dhënë vlerësim pozitiv për laboratorët dhe programet lidhur me profesionin e tyre.</p> <p>Në funksion të këtij programi studimi është një laborator informatike , ku studentët realizojnë orët e seminareve, si edhe laboratory I Kontabilitetit e financës, ku studentët mësojnë programet aplikative në këto lëndë. Duke parë edhe mundësitë e punësimit në fushat ekonomike dhe financiare, sipas studimit të tregut dhe vizitës në institucion, këto janë laboratër shumë të rëndësishëm për aftësimin e studentëve.</p> <p><i>Tabela 16 të dhëna për infrastrukturën dhe mjediset e FEA</i></p>						
Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standartit është e plotë duke qenë se mjediset mësimore dhe infrastruktura janë shumë të përshtatshme dhe të kompletuara për të realizuar me sukses programin e studimit dhe gjithashtu për të rritur kapacitetet e studentëve të lidhura me tregun e punës.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standartit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka përmban gjithë literaturën e nevojshme dhe të domosdoshme të lidhur me programin e studimit. Gjithë literaturat në formën e librave dhe revistave në gjuhën shqipe dhe të huaj janë të kategorizuara sipas standarteve të bibliotekave, ka punonjës të trainuar lidhur me organizimin dhe menaxhimin e bibliotekave. Numri i titujve është i lartë si në bibliotekën e UBT ashtu edhe në ate FEA. Ka patur përfitime të titujve nga disa projekte Ka po ashtu tituj të revistave, proceedings te konferencave kombëtare e ndërkombëtare, revista të Bankave dhe Instat, etj.</p> <p>Por patjetër që kërkohet një përditim me literaturat më të fundit, sidomos në shqip. Sot ka vlerë më shumë aksesit on-line në bibliotekat dixhitale dhe kjo duhet të garantohet. Duke qene se ka bibliotekë dixhitale në dispozicion, kjo siguron më shumë cilësi në literaturën për programin e studimit.</p>

<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjithashtu biblioteka ka edhe katalogimin online në systemin e bibliotekave COBIS, gjë që siguron përdoruesit të kenë informacion për gjithë titujt që janë në dispozicion si edhe të kërkojnë tituj për të cilët ka interes.</p> <p>Drejtnesit e bibliotekës dhe punonjësit e saj raportojnë përditësimin e titujve tek stafet akademike sipas departamenteve. Ndërsa njësia përgjegjëse dhe stafi akademik i programit komunikon përmes e-mail zyrtar mbi përditësimin e titujve dhe literaturave të nevojshme për programin e studimit.</p> <p>Burimet e bibliotekës janë kryesisht burime për stafet akademike, por edhe studentët informohen dhe nxiten më shumë në përdorimin e këtyre burimeve, sidomos nëpërmjet . Duhet thënë se studentët e UBT dhe si rrjedhim të MTR kanë mundësi të menjëhershme për përdorimin dhe aksesin e burimeve online duke qenë se kanë një llogari në system dhe adresa e-maili institucionale.</p> <p>Biblioteka ka mbi 19000 tituj në fondin e saj ku përfshihen tekstet mësimore si dhe literature ndihmëse si dhe janë të kategorizuara në tituj shqip dhe të huaj. Gjithashtu ka tituj nga periodikë të seleksionuar si edhe të paseleksionuar apo edhe tituj nga periodikë të shkarkuar si Elsevier dhe tituj nga periodikët online. Mbulohen afërsisht të gjitha modulet mësimore të programit të studimit. Megjithatë ka ende hapësirë për përditësimin e titujve sidomos në Shqip. Diskutimi me pedagogët e programit të studimit vuri në pah vështirësitë e botimit të librave në shqip, në përgjithësi jo vetëm për këtë program studimi. Por të gjithë pedagogët kanë mbështetur me cikle leksionesh të miratuara.</p> <p>Sipas informacionit mbi bibliotekën dhe rregulloret e programit të studimit studentët mund të shfrytëzojnë bibliotekën në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë. Madje mjediset e saj janë të pajisura me kompjutera dhe internet, ku studentët mund të shfrytëzojnë pa kosto për projektet e tyre të kursit, detyra , orare të studimit dhe leximit, e aksesit online nëpërmjet abonimeve të cilat janë të listuara tek Evidenca e informacionit mbi bibliotekën.</p> <p><i>Informacion mbi infrastrukturën e FEAs 2022.</i> <i>Informacion nga biblioteka shkencore "Mentor Përmeti"</i> <i>Vizita në institucion në mjediset e bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka "Mentor Përmeti" në UBT është e pajisur me programin COBIS për menaxhimin e katalogut të bibliotekës dhe gjithashtu jep mundësinë e aksesit në burimet e ndryshme elektronike ku institucioni është abonuar falë projekteve apo iniciativave të ndryshme për akses online të librave dhe revistave shkencore apo artistike, databazave online të artikujve.</p> <p><i>Informacion nga biblioteka shkencore "Mentor Përmeti"</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit</p>	<p>Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve në një orar të përshtatshëm me orarin e tyre mësimor, 8:30 – 16:00, duke patur parasysh që oraret e zhvillimit të mësimin janë paralelisht me këto orare dhe me orë pushimi, ku studentët mund të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës të pajisura edhe me kompjutera</p>

<p>mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p> <p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>dhe internet. Kapacitetet e saj janë të përshtashme për përgjigjen e numrit të studentëve të programeve të ndryshme të studimit dhe të programit EPZHR.</p> <p><i>Raportimi për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe për përditësimin realizohen nga stafi i bibliotekës. Pedagogët e stafit të programit në analizën në departamente japin informacion lidhur edhe me gjendjen e literaturave si dhe përditësimin e leksioneve dhe materialeve të cilat u shërbejnë studentëve por edhe fondit të bibliotekës. Kërkesat specifike për tituj nuk jepen, por në analizat vjetore I kushtohet një pjesë specifike me titull materialet didaktike, një raportimi për pjesën e leksioneve dhe teksteve si dhe nevojat për to.</i></p> <p><i>Informacion nga biblioteka shkencore "Mentor Përmeti"</i> <i>Analiza e veprimtarisë mësimore 2021-2022</i> <i>Analiza e veprimtarisë mësimore 2020-2021</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje e evidentuar në pjesën përshkrimore.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>


Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Sistemi i administrimit të të dhënave të studentëve ruhet dhe përpunohet pranë zyrës së studentëve si pjesë e degës së zhvillimit të kurrikulave, karrierës dhe vlerësimit institucional. Në rregulloren e kësaj zyre përcaktohen regjistrat që mbajnë informacionin e studentëve, duke përfshirë regjistrimin, regjistrat e arritjeve, vlerësimit dhe diplomimit. Nga ana tjetër sistemi Pitagora është duke u përdorur për hedhjen e të dhënave për regjistrimin e studentëve, faturat dhe pagesat, vlerësimet e studentëve, klasat transkriptet etj.</p> <p>Gjithashtu statuti I UBT parashikon rastet dhe strukturat për menaxhimin e të dhënave dhe strukturat për menaxhimin e të dhënave.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p><i>Sistemi Pitagora gjithashtu është planifikuar për menaxhimin e një pjesë të informacionit të stafit akademik, duke përfshirë orarin, lëndët nën përgjegjësi dhe kurset brenda një viti akademik. Ndërsa pjesa e të dhënave të tjera, si dhe për personelin ndihmës akademik dhe administrative apo partnere të tjerë të angazhuar me programin, nuk janë pjesë e sistemit. Ai është ende në elaborim për të përfshirë më shumë module që do të rritnin cilësinë e përpunimit të të dhënave.</i></p>

<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p><i>Statuti I UBT</i> <i>Manual I përdorimit të sistemit Pitagora</i></p>		
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Pjesa e sistemit që mund të lidhet me bashkëveprimin interaktiv dhe format e shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve, është në plotësim. Nga vizita në institucion u pa se komunikimi interaktiv bëhet përmes e-maileve zyrtare në institucion.</p> <p>Sistemi i menaxhimit siguron monitorim në kohë reale të vlerësimeve dhe realizimit të aktiviteteve akademik, dhe është në përmirësim për rritjen e të dhënave të përpunueshme për të monitoruar më thellësisht aktivitetin akademik, shpërndarjen e materialeve dhe komunikimi pedagog student.</p>		
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktiviteteve akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p><i>Statuti I UBT</i> <i>Manual I përdorimit të sistemit Pitagora</i> <i>Vizita në institucion, takim me pedagogët e programit të studimit</i></p>		
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktiviteteve ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Duke studiuar Web-site të UBT shohim se informacioni është i përdituar, ka dhe informacion në gjuhën angleze, por nuk është i vendosur plotësisht në dy gjuhë.</p> <p>https://www.ubt.edu.al</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Shkalla e përmbushjes së këtij standardi është plotësisht duke qenë se sistemi i menaxhimit të informacionit elektronik është në funksionim. Sygjerohet që sa më shpejt të bëhet edhe përkthimi i informacionit në Web-site në gjuhën angleze.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Ligji i arsimit të lartë 80/2015 krijon gjithë hapësirat ligjore për ndërtimin e mekanizmave të duhur për menaxhimin financiar të institucionit dhe pjesëve përbërëse të tij. Në bashkëveprim me ligjin e buxhetit, si edhe me udhëzimet përkatëse, por edhe me komponentin administrative, tashmë të ndarë nga ai kërkimor shkencor, në universitete, është e mundur të kalohet deri në nivelin e programeve të studimit. Në relacionin për realizimin e buxhetit dhe planifikimin, mund të evidentohen elementet e realizimit financiar të budhetit, Por nuk ka evidencë për koston mesatare vetëm të studentëve të programit bachelor EPZHR. Gjithsesi kjo kosto ndryshon në varësi të grantit dhe numrit të studentëve. Parashikimet për vitete e arshshme bëhen në projekt</p>



	<p>buxhetin afatmesëm. Të gjitha parashikimet financiare dhe planifikimi bëhen bazuar mbi të gjitha procedurat ligjore për institucionet e Arsimit të Lartë.</p> <p><i>Relacion për realizimin e buxhetit 2021 dhe planifikimi 2022.</i></p>		
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Planifikimi financiar fillon që nga njësia bazë me kërkesat e paraqitura nga përgjegjësi I departamentit në dekanat dhe më pas në senatin akademik dhe bordin e administrimit. Planifikimi përmban edhe kosto si shpenzimet për bibliotekën dhe materiale të tjera didaktike të nevojshme. Analiza financiare dhe raportet, paraqiten në rektorat, senatin akademik dhe marrin miratimin përfundimtar në Bordin e Administrimit. Në mbyllje të cdo cikli të plotë studimi institucioni dokumenton raportet financiare për tre vitet e fundit dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> <p><i>Statuti I UBT</i> <i>Relacion për realizimin e buxhetit 2021 dhe planifikimi 2022.</i></p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni përgatit raportet vjetore financiare dhe gjithë procedurat për miratim të vendimeve që lidhen me buxhetin dhe financat përcaktohen në statut dhe rregullore, të cilat zbatohen me rigorozitet.</p> <p>Raportimet janë në nivel institucional dhe ao të lidhura me realizimin e buxhetit nuk shkojnë deri në nivel programi studimi.</p> <p><i>Statuti I UBT</i> <i>Vizita në institucion</i></p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Qëndrueshmëria financiare e institucionit garantohehet për shkak të fondit nga granti I MAS, të cilat kanë ardhur në rritje në tre vitet e fundit. Gjithashtu në rritje kanë qenë edhe të ardhurat nga studentët për shkak të rritjes së numrit të programeve të studimit dhe numrit të studentëve në disa prej tyre.</p> <p><i>Relacion për realizimin e buxhetit 2021 dhe planifikimi 2022.it</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Shkallën e përmbushjes së standardit është plotësisht pasi institucioni realizon buxhetimin, evedentim të kostove dhe analizave financiare dhe auditimit.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje paraqiten në statutin dhe rregulloret përkatëse të institucionit dhe FEAs. Kuotat e pranimit të studentve për çdo vit akademik shqyrtohen dhe propozohen nga njëسيا bazë. Këto kuota propozohen nga institucioni tek MAS, bazuar në legjislacionin në fuqi.</p> <p>Sa I përket ciklit të plotë, deri në dalje UBT ka disa zyra që mbështesin studentët përgjatë qëndrimit të tyre, si zyra e procesit mësimor, ajo për zhvillimin e karrierës. Të gjitha proceset gjatë programit të studimit, në diplomim dhe pas diplomimit mbështeten nga zyrat e UBT.</p> <p><i>Statuti UBT</i> <i>RRegullore UBT</i> <i>RRegullore FEAs 2018</i> <i>Propozim për kuotat e studentëve dhe tarifave</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas Rregullores FEA, studimet në EPZHR mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarë etnikë dhe të huaj sipas kriterëve të përcaktuara. Strukturat e njësisë bazë, Zyrës së Studentëve dhe Qendrës së Karrierës japin shërbimet dhe mbështetjen e tyre pa asnjë dallim dhe diskriminim për të gjithë studentët duke i trajtuar ata në kushte të barabarta. Ofrimi i informacionit dhe shërbimeve bëhet sipas nevojave të studentëve. ESSE3 dhe transparenca e informacionit mbështet procesin për garantim të të drejtave të njëjta.</p> <p><i>Statuti UBT, neni 3 pika 7</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Njëسيا bazë propozon kuotat e pranimit si edhe kriteret e pranimit, që në rastin e këtij programi nuk është se janë të vecanta. Pranimi në këtë program studimi bëhet sipas kërkesave ligjore në fuqi për çdo student që ka përfunduar maturën shtetërore, duke përfshirë edhe shtetas të huaj sipas kuotave dhe kriterëve të përcaktuara nga MAS. Pranimi dhe regjistrimi i studentëve bëhet sipas udhëzimeve dhe kuotave që në fund përcaktohen nga MAS.</p> <p><i>Rregullore e brenshme e FEAs.</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së</p>	<p>Transparenca është një nga kriteret e punës në UBT dhe gjithashtu në programet e ndryshme të studimit pra edhe në programin dhe departamentin MTR. Ka disa mënyra se si shpërndahe informacioni mbi kriteret e pranimit të studentëve, së pari në bashkëpunim me QKA promovohet njëسيا bazë dhe</p>

<p>studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>programi tek shkollat e mesme (aneks 20 broshurë promovuese UBT). Publikohen kuotat e pranimit kriteret dhe programet e studimit në portalin U-Albania.</p> <p>Informacioni mbi përparimin përgjatë kursit të studimit, transferimet dhe njoja e studimeve të mëparshme është i aksesueshëm për studentët e interesuar përmes sistemit të menaxhimit të informacionit, por edhe përmes marrjes së shërbimit dhe dokumentacionit nga stafet mbështetëse administrative, sekretaritë etj. Në rregulloret e UBT, FEA janë të qarta kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve, kriteret e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme dhe vlerësimi i dijeve. (Aneks 11 dhe aneks 12).</p> <p>Publikimi i informacionit për sa më sipër në Web-site e UBT dhe gjithashtu në faqet sipas departamenteve për programet e studimit, është garanti themelor për aksesueshmërinë nga publiku. Por edhe mjete tradicionale të marketingut dhe informimit si banera dhe stenda në ambientet e UBT përdoren për informimin e publikut dhe studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Informacioni për aplikantët maturantë, lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit EPZHR përgatitet nga njësia bazë në koordinim me QKA. Ky informacion është në formën e një pakete orientuese dhe përdoret gjatë vizitave në shkollat e mesme në fushën promovuese Programet e studimit, kuotat së bashku me kriteret e pranimit publikohen dhe janë lehtësisht të aksesueshme në portalin U – Albania. Zyra e karrierës dhe studentëve pranë FEA luan një rol të veçantë promovues për të nxitur studentët të zgjedhin FEA dhe në këtë kuadër edhe DEPZHR për karrierën e tyre të ardhshme. Botimi në Web-site të UBT gjithashtu bëhet përpara se sa të follojë periudha e aplikimeve për në universitet.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> <p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Si për gjithë programet, edhe për këtë program botohen kuotat për studentët me aftësi apo kushte të vëncata, kjo në zbatim të rregullave dhe legjislacionit përkatës dhe kuotave të MAS.</p> <p>Në rastet e kuotave për student të huaj, UBT lejon ndjekjen e studimeve edhe nga këta student menjëherë pasi të kenë ekuivalentuar diplomën e shkollës së mesme, sipas rregullores së brendshme të FEAs. Studentët e huaj gjithashtu mund të transferojnë studimet</p> <p><i>Rregullore e FEAs</i> <i>Broshurë e Promovimit të UBT.</i> <i>Propozim i kriterëve për pranimin e studentëve 2022-20221, 2021-2022, 2022-2023, etj.</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Politikat e bursave/ndihmës për shtresat në nevojë janë të ngritura nga MAS dhe zbatohen nga institucioni sipas të gjithë kornizës ligjore në fuqi. Po sipas kriterëve ligjore në fuqi institucioni ofron mbështetje nëpërmjet përjashtimit nga tarifatat vjetore të shkollimit.</p> <p><i>Statuti UBT 2021</i></p>

	<i>Rregullore e FEAs, 2017</i> <i>Njoftim për studentët për përfitimin e bursave 2022-2023</i>		
Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standardit është plotësisht duke qenë se institucioni përmbush gjithë kornizën ligjore në fuqi, si dhe ka ndërtuar rregullore dhe procedura për të zbatuar këtë kornizë, lidhur me pranimin e studentëve, mbështetjen e tyre në procesin e shkollimit, mundësitë që u jep lidhur me mbështetjen financiare si dhe kriteret e tjera të sipërpërmendura.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në statutin e UBT, në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e FEAs paraqiten të gjitha procedurat se si studentët përparojnë gjatë programit, në lidhje me kurset, kreditet, kalimin nga një vit në tjetrin, diplomimin. Kohëzgjatja e studimeve, kushtet e kalimit në vitin pasardhës dhe ecuria e studimeve janë elemente të parashikuara në rregulloret e FEA dhe rregulloren e studimeve EPZHR. Aksesimi nga publiku garantohej nga publikimi i rregulloreve në Web-site e UBT. Procedurat e përparimit akademik lidhen me procesin e mësimdhënies, informacioni për të cilin bëhet transparent në Web-site e pedagogut për modulin përkatës, si edhe përgjatë semestrave dhe vitit akademik. Çdo pedagog vendos në dispozicion syllabusin, me informacion mbi kreditet, synimet, temat, mënyrën e vlerësimit dhe këto shërbejnë për informimin e studentit se si do të mund të përparojë gjatë studimeve në çdo modul.</p> <p>Rregulloret gjithashtu përmbajnë nenet përkatëse për të informuar studentët në rastet e transferimeve për procedurat e njohjes së provimeve të mëparshme bazuar mbi programet si edhe njohjen e lëndëve dhe provimeve nga komisionet ad-hoc të ngritura për këtë qëllim.</p> <p>Takimet informuese me studentët e kursit të parë nga përgjegjësi i departamentit dhe stafi akademik përbëjnë edhe një element shtesë për informimin mbi modulet, procedurat dhe mënyrat e përparimit të studentëve përgjatë gjithë periudhës së studimeve.</p> <p>Zyra e studimeve dhe studentëve, sekretaritë mësimore dhe laborantet e departamenteve janë në dispozicion të studentëve të interesuar për të marrë më tepër informacion për çdo çështje me interes përgjatë periudhës së studimeve.</p> <p><i>Statuti UBT 2021</i> <i>Rregullorja e studimeve Universitare UBT, 2021</i> <i>Rregullorja e FEAs 2017</i> <i>Rregullore e ciklit të parë të studimeve bachelor në EPZHR, 2022.</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit të studentëve janë të mirëpërcaktuara dhe të shpallura në faqen e Internetit përmes Statutut dhe rregulloreve përkatëse.</p> <p>Informimi I studentëve gjithashtu ndodh në takimet e sipërpërmendura informuese në cdo fillim viti akademik.</p> <p><i>Statuti UBT 2021</i> <i>Rregullorja e studimeve Universitare UBT, 2021</i> <i>Rregullorja e FEAs 2017</i> <i>Rregullore e ciklit të parë të studimeve bachelor në EPZHR, 2022.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Fushata të informimit të studentëve si edhe faqja e Internetit janë dy mjete kryesore për udhëzimin dhe informimin e të interesuarve për të studiuar pranë UBT si dhe në programin e studimit.</p> <p>Fakulteti gjithashtu ka dizenuar një fletëpalosje ku informon dhe nxit aplikantët për të studiuar në FEA, duke informuar për programet e ndryshme, avantazhet dhe mundësitë për punësim, etj.</p> <p><i>10. Ditët e informimit të maturanëve</i> <i>11. Fletëpalosje FEA.</i> www.ubt.edu.al</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Shkalla e përmbushjes së standardit është plotësisht për shkak se informimi i studentëve mbi rrugën e tyre të përparimit akademik është i garantuar dhe mjetet e informimit përdoren në mënyrën e duhur.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Struktura, organizimi dhe kohëzgjatja e programit të studimit është e parashikuar në rregulloren e FEAs dhe rregulloren e programin e studimit. Përveç informimit përmes rregulloreve të publikuara në faqen e Internetit gjithashtu informacion jepet nëpërmejt takimeve në fillim të vitit akademik, sic u përmendën edhe më lart.</p> <p>Rregullore e programit të studimit jep gjithashtu informacionin e nevojshëm për lëndët, modulet e programit të studimit. Mënyra se si institucioni informon studentët mbi programet e studimit dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese është përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Botimit të kurrikulës së detajuar me informacion për lëndët/modulet, kreditet, përmbajtjen dhe kategorizimin e veprimtarive në Web-site • Botimit në Web-site të pedagogëve të programeve dhe syllabuseve të lëndëve përkatëse • Botimit të Guidës së FEA ku gjendet informacion



<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantimit me informacionin që në fillim të regjistrimit të studentëve në UBT dhe në takimet e para informuese • Sekretarive dhe ZSS si edhe personelit mbështetës administrativ në department <p>Elementi primar që i shërben institucionit dhe specifikisht departamentit për të promovuar studentët në tregun e punës është praktika profesionale. Në këtë diplomë mbështen studentët në procesin e praktikës duke sygjeruar dhe garantuar marrëveshje me kompani/organizata/administrate. Kjo i ndihmon ata për të bërë një prezantim të mirë fillestar në tregun e punës.</p> <p>Koordinimi me QKA është hapi i dytë përmes së cilit DEPZHR mbështet studentët në përballjen me tregun e punës. Ky process bashkëpunimi ka rezultuar efikas (intervistat me studentët) në aspektin e këshillimit për ndërtimin e CV, aplikimit për punë, letrës së motivimit, kërkimit të informacionit për punë, etj. Panairi i karrierës ka qenë dhe procesi përmes të cilit mbështeten studentët me oportunitete më konkrete në tregun e punës. Përpilimi i skedës së punësimit është dokumentacion mbështetës që ndihmon në process dhe në bazën e të dhënave. Projekti më i fundit GRADUA, paraqitet nga pedagogët dhe nga intervista në QKA si një projekt që do të rritë oportunitetet e studentëve falë krijimit të platformës për informacion në tregun e punës.</p> <p><i>Rregullorja e studimeve Universitare UBT, 2021</i> <i>Rregullorja e FEAs 2017</i> <i>Rregullore e ciklit të parë të studimeve bachelor në EPZHR, 2022.</i> <i>Kërkesa dhe kontrata për praktikë profesionale në bachelor</i> <i>Ftesë panairi VII I karrierës QErshor 2022</i> <i>Fletëpalosje FEA</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Informacioni i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, gjendet dhe vendoset në mënyrë të dukshme në të gjitha hapësirat fizike.</p> <p>Informacioni mbi orarin dhe sallat është i afishuar në stenda, dhe në faqen e Internetit. Sallat janë të etiketuara me numra të cilat përputhen me informacionin në orar, zyrat e pedagogëve, stafit administrative gjithashtu kanë numrat dhe emrat përkatës. Sinjalistika shërben për të orientuar studentët në mënyrën e duhur për shfrytëzimin e mjediseve, infrastrukturës dhe shërbimeve.</p> <p><i>Vizita në inëtitucion në amjentet e ndryshme dhe në auditorët e përdorur për programin e studimit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Sistemi I menaxhimit të brendshëm të informacionit menaxhon pjesën e vlerësimeve, e si rrjedhim edhe me kurset që ndjekin studentët gjatë semestrit dhe është lehtësisht I arritshëm . Ndërkohe infoarmacioni ndodhet edhe në faqen e Internetit , mbi lëndët dhe modulet duke qenë lehtësisht I arritshëm për studentët.</p> <p>Manuali I përdorimit PITAGORA www.ubt.edu.al</p>

Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standardit, është plotësisht duke qenë se institucioni realizon informacion të plotë studentëve për programin, modulet, procesin e edukimit dhe diplomimin.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>UBT përmes Zyrës së Informacionit dhe Statistikës në bashkëpunim me ZSS grumbullon dhe përpunon të dhënat lidhur me regjistrimet/aplikimet duke përpunuar të dhënat lidhur me moshën, shpërndarjen gjeografike, trajtimin me bursa, numrin e të diplomuarve, etj</p> <p>Institucioni përmes zyrave të mësipërme gjithashtu mban informacion për të gjithë studentët që janë larguar nga programi përpara përfundimit apo për mospërfundimin me sukses të programit. Evidentimi për këtë fakt u bë në ZSS në regjistrat, duke marrë një kampionim për programin e studimit dhe për të parë standartet e ruajtjes së informacionit. Gjithashtu evidence tregojnë edhe dokumentat e mëposhtëm.</p> <p>Rregullore e DZHKKVI Rregullore e brendshme e FEAs 2017, nenet 23, 59 dhe 66.</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësisve përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Të dhënat statistikore menaxhohen përmes sistemit tradicional të shpjeguar më lart dhe ZSS, duke u ruajtur në regjistra së bashku me vlerësimet dhe arttjet akademike . Të dhënat e studentëve ruhen në sistemin e menaxhimit të informacionit përmes skedave të tyre Log-in, në mënyrë që ata të garantojnë marrjen e rezultateve përmes sistemit.</p> <p>Përmes rregullores së FEAs garantohej ruajtja dhe konfidencialiteti I të dhënave individuale.</p> <p>ZSS, pra zyra e Studimeve dhe Studentëve është gjithashtu përgjegjëse për menaxhimin e dokumentacionit në mënyrë që të ketë mundësi të vlerësojë gjendjen aktuale dhe saktësinë e informacionit të studentëve dhe vlerësimeve të tyre të arritjeve akademike.</p> <p><i>Vizita në Institucion sekretaria mësimore Rregullore e FEAs, Manuali I sistemit Pitagora</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al


E-mail: info@asc.al

<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>DEPZHR harton raporte analitike të përvitshme të punës së departamentit, duke përfshirë në raport edhe të dhënat lidhur me profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje, duke përfshirë informacion si notat mesatare, kuotat e regjistrimit dhe numri actual I të regjistruarve, numri I studentëve të larguar, etj., duke bërë dhe analizat përkatëse dhe sygjëruar veprime për të ardhmen bazuar mbi këto statistika.</p> <p><i>Analiza Mësimore dhe kërkimore FEA, 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Shkalla e përmbushjes së standardit është plotësisht duke qenë se të dhënat dhe statistikat vjetore të studentëve ruhen në mënyrën e duhur si edhe përpunohen nga institucioni, duke garantuar mbrojtjen e të dhënave personale, por sidomos duke siguruar mundësi për analiza më të thelluara të cilat do t'i nevojiten vendimmarrjes. Kujdes duhet që këto përpunime dhe analiza që tashmë bëhen, të vihen në përdorim sa më efektiv për vendimmarrje lidhur me programin e studimit në fjalë EPZHR.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Studentët janë pjesë e strukturave drejtuese sipas ligjit 80/2015, përkatësisht përbëjnë 10% të senatit akademik, që do të thotë 3 studentë prej 25 anëtarë të senatit. Studentët përfaqësohen edhe në përbërje të komisioneve të përhershme përveç në komisionin e dhënies së gradave dhe titujve. Studentët organizaohen në këshilla studentore në nivel fakulteti dhe UBT. Këshillat e studentëve janë organizata të pavarura të cilat nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike apo politike, por sigurojnë pjesëmarrjen e studentëve në procesin zgjedhor dhe koordinojnë pjesëmarrjen me përfaqësim në organet drejtuese, sipas ligjit për arsimin e lartë 80/2015. Studentët përfshihen gjithashtu edhe në veprimtari të tjera lidhur me institucionin, psh., në QKA, përmes një anëtari të angazhuar vullnetarisht.</p> <p><i>Statuti i UBT</i> <i>Rregullore e Brendshme e FEAs, 2017</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve</p>	<p>E drejta e studentëve për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur në mënyrë që të përfaqësohen në organet drejtuese dhe komisionet e përhershme garantohe</p>



<p>dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>nga statuti i UBT. Nga ana tjetër studentët marrin pjesë në procesin e vlerësimit të punës së programit dhe pedagogëve përkatës, kjo përmes formularit të anketimit të studentëve. Ky proces u jep atyre një fuqi reale për të ndikuar në proceset e mëtejshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Studentët kanë rol në organizimin e panairit të karrierës, duke punuar vullnetarisht për këtë organizim. UBT siguron gjithashtu mbështetje për veprimtaritë e studentëve jashtë kurrikulës, që mund të jenë veprimtari muzikore, sportive, bamirësie etj.</p> <p><i>Rregullore e brendshme e FEAs</i> <i>Format pyetësori për vlerësimin e procesit mësimor</i> <i>Vizita në institucion, takimi me zyrën e karrierës</i></p>		
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Departamenti I EPZHR ka në rregulloren e tij nenin që pasqyron mbajtjen parasysh të ngarkesës akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesëshme të mëparshme. Në një rast kemi marrjen parasysh të analizave dhe feedback-ut të studentëve në kuadër të projektit GRADUA që kanë rezultuar në marrjen e disa masave për rishikim dhe përmirësim të programit lidhur me praktikën mësimore apo disa elemente të ngarkesës.</p> <p><i>Relacion mbi axhustimet e kurrikulës</i></p>		
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Dy janë momentet ku pasqyrohet marrja parasysh e mendimeve të studentëve për hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmes plotësimit të anketave, ku një informacion i kërkuar është përmes pyetjes së lidhur me procesin mësimor dhe programet apo informacionin në lidhje me lëndën. <p>Përmes komunikimit në klasë mbi kuptimin e lëndës, tematikës, bashkëveprim në seminare, shqyrtime rreth studimit, apo pyetjeve nëse kërkojnë diçka të ndryshme apo tjetër lidhur me metodat dhe procesin e mësimdhënies.</p> <p><i>Rregullore e brendshme e FEAs</i> <i>Format pyetësori për vlerësimin e procesit mësimor</i> <i>Vizita në institucion, takimim me studentët dhe pedagogët e departamentit.</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Shkalla e përmbushjes së standardit është plotësisht duke qenë se inshtitucioni përmbush kushtet dhe kriteret ligjore për përfshirjen e studentëve jo vetëm në organiet vendimmarrëse, por edhe nëpërmjet rregulloreve dhe procedurave të zbatuara, edhe në përmirësimin e procesit të mësimdhënies.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

Standardi V.6


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Struktura drejtuese e UBT e njësisë kryesore dhe e njësisë bazë DEPZHR, janë në shërbim të vazhdueshëm të studentëve të kësaj dege. Dy fushat që bazohet shërbimi i studentëve janë: mesimdhënia dhe zhvillimi i karrierës. Ofrimi i shërbimeve dhe informacioneve është funksion dhe symin kryesor i ZSS. Ajo u ofron studentëve informacion mbi gjithë hallkat e procesit të arsimit, informacion të dobishëm për mbarëvajtjen e procesit akademik të tyre si edhe informacion në raste transferimesh, midis IAL-ve Edhe QAKS ofron informim për studentët, por sidomos në pjesën e fundit të studimeve të tyre, në qasjen me tregun e punës, por edhe lidhur me praktikat dhe kompanitë në treg.</p> <p>Rregullore e DZHKKV, 2017</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>ZSS ofron informacionin kryesor për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Çështjet për të cilat mund të informohen studentët nga ZSS më konkretisht janë të lidhura me regjistrimin, plotësimin e diplomave, programet dhe kurrikulat e diplomimit, transferimet nga një fakultet në tjetrin, zhvillimi i procesit mësimor. ZSS jep gjithashtu edhe shërbime për studentët si suplementin e diplomës, marrjen e vërtetimeve të studentit, programe lëndësh, transferim studimesh, vendim çregjistrimit etj. Sa I përket aspekteve të lidhura strikt me procesin mësimor, stafet akademike në faqet e tyre japin infoarcionin përkatës mbi lëndët apo modulet. Lidhur me vlerësimet ato merren gjithashtu prej sistemit PITAGORA I cili është vënë në funksionim.</p> <p>Statuti UBT Rregullore e UBT Rregullore e DZHKKV, 2017</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Qendra e Karrierës dhe Alumni QKA u shërben studentëve, duke u ofruar si zyrë e rektoratit, por e shpërndarë edhe në fakultet dhe departamnete, për të mbështetur zhvillimin e karrierës së studentëve. QKA në bashkëveprim dhe me ZKS apo DMTR oforn informacion mbi punësimin e mudnëshëm, praktikat, internship n bazë të programeve përkatëse. QKA ka mbështetur studentët në njohjen më të mirë të procesit të aplikimit për punë dhe dokumentacioneve të nevojshme. QKA ka ndërtuar dhe po zbaton formularin e studimit. Ajo gjithashtu ka krijuar shumë mundësi për punësimin në tregun e përshtatshëm të punës, përmes promovimit dhe marrëveshjeve me kompani dhe organizatat, si dhe me ruajtjen e marrëdhënieve me alumni.</p> <p>Rregullore e DZHKKV, 2017</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion</p>	<p>Njësia bazë është ajo e DEPZHR dhe në bashkëveprim me QKA mbledh dhe përpunon të dhëna për studentët pas diplomimit. Kjo realizohet falë plotësimit të formularit të gjurmimit, i cili kërkohet të plotësohet nga studentët përpara marrjes së diplomës. Studimi evidenton dhe analizon këto aspekte:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Profili i studentit • Vlefshmëria e diplomës së UBT për tregun e punës




studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	<ul style="list-style-type: none"> Punësimi i tyre. <p>Studimi është i përvitshëm dhe raporti publikohet dhe është në dispozicion të çdo student në UBT por që mund ta aksesojnë në QKA.</p> <p><i>Qendra e karrierës dhe Alumni UBT, akt themelimi 2018</i> <i>Raport gjurmimi I studentëve në UBT</i> <i>Raport panairi I karrierës.</i></p>		
Konkluzione	<p><i>Shkalla e përmbushjes së standardit është plotësisht pasi procedurat për orientimin e studentëve gjatë studimeve edhe pas përfundimit të tyre janë të mirëpërcaktuara nëpërmjet ngritjes së zyrave përkatëse si edhe të mirëzbatuara nga departamenti dhe për programin e studimit.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p> <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Duke u mbështetur në disa dokumente themelore sic janë Statuti I UBT, plani strategjik I UBT, 2016-2025 si edhe planin e Veprimit FEA dhe Manualit të Cilësisë, ka një sërë parimesh që vendosin mësimdhënie në një pozicion të favorshëm duke paraqitur nxitjen për përdorimin e metodave inovative.</p> <p>Sipas manualit të cilësisë, misioni, vizioni (aneks në raport), UBT e mbështet punën e vet në ndershmërinë, kreativitetin, lirinë akademike, bashkëpunimin dhe shkëmbimin për kërkimet në shkencë, dhe edukim. Universiteti Bujqësor i Tiranës ka përgjegjësinë që t'i ofrojë shoqërisë shqiptare një cilësi të lartë të programeve akademike, hulumtuese dhe shërbimesh; të tregojë se po bën përpjekjet e mundshme për të përdorur në mënyrë efektive dhe efikase burimet e ofruara dhe të sigurojë që janë plotësuar standardet e cilësisë. Për të arritur sigurimin e cilësisë, UBT ka zhvilluar një politikë të sigurimit të cilësisë dhe ka ngritur një sistemin të menaxhimit të cilësisë. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë në UBT-së përmban disa çështje lidhur me metodat inovative, zhvillimin e tyre dhe monitorimin, sic janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përgjegjësi e menaxhimit - angazhimi i strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë; - sigurimi i burimeve për garantimin dhe përmirësimin e cilësisë;

	<p>- mësimdhënia, mësimi, hulumtimi dhe shërbimet – përmes zhvillimit dhe shpërndarjes së programeve cilësore që plotësojnë nevojat e shoqërisë; Zhvillimi i një sistem eficient në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimin, menaxhimin dhe politikën e vendim marrjes - Sigurimin e autonomisë së punës së pedagogëve dhe pozicionin jo diskriminues të studentëve - Internacionalizimin e edukimit të arsimit të lartë - Monitorimin e infrastruktures se kerkuar per zhvillimin sa më cilësor të arsimit te larte. - Organizimit të proceseve të mësimdhënies, të menaxhimit dhe mbështetjes. <p>Pikërisht zbatimi I këtyre orientimeve duke përfshirë dokumentet strategjike dhe manualin e cilësisë kanë garantuar krijimin dhe monitorimin e metodave innovative në UBT dhe në këtë program studimi.</p> <p><i>Statuti UBT</i> <i>Plani strategjik I UBT 2016-2025</i> <i>Plani zhvillimit FEA</i> <i>Manuali I cilësisë, UBT 2018</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Dy herë në vit realizohen pyetësorë, ku në to u kërkohet studentëve të shprehin mendimin dhe vlerësimin e tyre për pedagogët në mënyrën se si ata zhvillojnë lëndët që mbulojnë dhe se sa praktike apo i sukseshëm ka qënë metodologjia dhe praktika e realizuar nga ta. Monitorimi vlerësimi nga studentët bëhet menjëherë përpara fillimit të sezonit të provimeve duke mos e përfshirë këtë të fundit.</p> <p>Manuali i cilësisë UBT 2018 Pyetësor për vlerësimet e studentëve</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Të gjitha strukturat e institucionit sigurojnë një shërbim cilësor dhe nxisin rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet. I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë. Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor të Institucionit dhe me Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimin Institucional që ka përgjegjësinë institucionale. Njësia e sigurimit të cilësisë është pjesë e drejtorisë DVSC. Senati si organi më i lartë akademik ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Këto struktura janë përgjegjëse jo vetëm për sigurimin dhe monitorimin e cilësisë, por edhe për garantimin e transparencës, duke kaluar analizat e vlerësimit të performancës, të dhënat e pyetësorëve të realizuar etj., nëpërmjet hierarkisë deri në nivel departamenti. Sa i përket publikimit për studentët janë vendosur vetëm rankime dhe akreditimi ne faqen e internetit.</p> <p><i>Statuti UBT</i> <i>Rregullore e DVSC, 2021, kreu V neni 15.</i> <i>Analiza Mësimore dhe Shkencore e UBT, 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022.</i> https://www.ubt.edu.al/sigurimi-i-cilesise</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe</p>	<p>Si në manualin e sigurimit të cilësisë, ashtu edhe në dokumente të rregulloreve përkatëse, paraqiten orientime se si mund të promovohen shembujt e</p>



rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>praktikave më të mira. Analizat vjetore përmbajnë kryesisht argumente të përmbushjes së aspekteve ligjore dhe rregullatore,</p> <p>Tek Manuali specifikisht tek seksioni mbi Sigurimin e brendshëm të cilësisë ka mundësi të trajtohet edhe mënyrat se si promovimi i shembujve më të mirë mund të përfshihet në procesin e përmirësimit të cilësisë për stafet akademike.</p> <p><i>Manuali i cilësisë</i> <i>Analiza Mësimore dhe Shkencore e UBT, 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022.</i> https://www.ubt.edu.al/sigurimi-i-cilesise</p>		
Konkluzione	<p><i>Shkalla e përmbushjes së këtij standardi është kryesisht. Institucioni ak ngritur dhe vene ne funksion strukturat përkatëse për sigurimin e cilësisë, prej një kohe të konsiderueshme tashmë, ka eksperiencë në këtë drejtim dhe ka vene ne funksionim rregulloret perkatese si dhe ka ofruar dokumentacion të plotë ligjor dhe rregullator lidhur me sigurimin e cilësisë.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës nëpërmjet Rregullores së Studimeve të UBT, <i>i miratuar në mbledhjen e Senatit Akademik, datë 28.03.2017, Kreu XIII, Neni 90, Fq 56. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë, si dhe Neni 91, Fq 56. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë,</i> parashikon dhe garanton politika dhe procedura të vlerësimit të cilësisë.</p> <p>Statuti i UBT, në nenin 69 të tij, parashikon hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë ku pranë DVBSK është organizuar dhe funksionon Njësia e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë me këtë fokus veprimtarie:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidentimin e problematikave të lidhura me mësimin. - Evidentimin dhe ndjekjen e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies. - Sigurimin e bazës së të dhënave për cilësinë e mësimdhënies. - Vlerësimin periodik i rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. - Realizimi i studimeve për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Universiteti. - Organizimi dhe ndjekja e zhvillimit të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo programi studimi. - Orientimin dhe udhëheqjen metodike të procedurave të veprimit për vlerësimin e brendshëm në departamente dhe fakultete. - Vlerësimin e performancës së stafit akademik. <p><i>Rregullorja e Studimeve UBT, 2017</i> <i>Statuti i UBT, 2021 neni 85</i></p>

	<i>Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.</i>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Strategjia institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë jepet në dokumentet themelore si Planet strategjik I UBT dhe plani strategjik I kërkimit shkencor. Institucioni ndërton një skemë/procedurë të tillë të kontrollit dhe manaxhimit të të gjitha ndryshimeve të përvitshme, dhe e standartizon atë përmes kanaleve hierarkike ku vijon i gjithë procesi. Përgjatë viteve, e gjitha kjo kthehet në një procedurë të nevojshme e cila përveçse përmirëson procesin por edhe rrit cilësinë.</p> <p>Gjatë procesit të vlerësimit të cilësisë FEA ka bërë pjesë të gjithë studentët për vlerësimin e performancës në mësimdhënie dhe çdo gjë tjetër që lidhet me komunikimin e pedagogut me studentët si edhe të gjithë pedagogët anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës që angazhohen në këtë proces. DEPZHR si njësi bazë ka qenë aktiv gjatë këtij procesi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit bashkëpunon intensivisht me aktorët e biznesit si edhe strukturat e tjera publik edhe private duke i përpjekur ti përfshijë ata në përmirësimin e procesit të mësimdhënies, kërkimit apo rritjes së cilësisë së programit të studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Lista e Marreveshjeve UBT_Praktika Profesionale , QKA</i> - <i>Marreveshjet Bashkepunime Institucion UBT Kërkim</i> <p>Për këtë personalitetet e fushës apo ekspertë ftohen për orë të hapura dhe si lektorë të ftuar në mënyrë të vazhdueshme në auditorët e UBT/FEAs.</p> <p>Megjithatë nuk ka procedura dhe procese formale e të shkruara për të zyrtarizuar se si marrëdhëniet e bashkëpunimit do ndikojnë në kuadrin e vlerësimeve të jashtme dhe këto duhen evidentuar dhe mirëpërcaktuar në dokumentet strategjike.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>DEPZHR në vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit bachelor përdor metoda dhe metodologjitë qarta të saj që i referohet standardeve shtetërore të cilësisë në arsimin e lartë. Në Manualin e cilësisë këto elemente janë të shprehur qartë. Gjithashtu në Analizën vjetore të Punës Mësimore Kërkimore të Departamentit, në këtë kuadër vlerësohen: a) Programet e studimit, b) Procesi mësimor, c) Stafit akademi.</p> <p>d) Studentët, e) Organizimi dhe menaxhimi i brendshëm, f) Veprimtaria mbështetëse dhe aspekte të tjera të veprimtarisë.</p> <p>UBT/FEA në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit Bachelor EPZHR përdor metoda e instrumente të ndryshme vlerësimi si sondazhe të studentëve, intervista në panairin e karrierës, anketime nga të diplomuar në UBT për të vlerësuar performancën e programit të studimit.</p> <p>UBT ka pjesë të strukturave të saj konsultative edhe bordin e Aumni si një organ konsultativ për përmirësimet kurrikulare dhe jo vetëm. UBT ka lidhur më shumë se 50 marrëveshje me biznese dhe institucione për realizimin e praktikave profesionale dhe për të përmirësuar procesin e krijimit të</p>

	kompetencave profesionale të gjithë atyre që ndjekin studimet në çdo program të UBT. <i>Manuali i NJBSC Vlerësimi sipas Standarteve.</i> <i>Raporti i Analizës Mësimore-Kërkimore FEA, 2019-2020, 2020 -2021, 2021-2022.</i>		
Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standardit është plotësisht pasi institucioni harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Vlerësimi i programit është proces që kryhet periodikisht, kalon në shumë etapa dhe hallka dhe tashmë është institucionalizuar përmes metodologjisë së përdorur. Informacionin që mblidhet nga burime të ndryshme, duke nisur me studentët, pedagogët apo mbledhjet formale, që rezultojnë si output i procesit dhe që prek dhe përfshin të gjitha hallkat e aktivitetit, institucioni e reflekton përmes procesit të vlerësimit periodik të programit, duke e kthyer këtë proces në një standart dhe instrument vlerësimi. Duke rishikuar programet e lëndëve, metodat dhe elemente të ndryshme të procesit të mësimdhënies, procesi i sigurimit të cilësisë rezultojnë në një metode nga poshtë-lart.</p> <p>Universiteti përcakton filozofinë, politikën dhe procedurat në rang UBT të cilat më pas aplikohen në rang departamenti. Sigurimi i brendshëm i cilësisë bëhet në tre mënyra kryesisht: a) nepermjet pyetjeve të drejtuara studentëve (shqyrtuar në kriterin më sipër) të cilat plotësohen çdo semester; b) nepermjet asistimeve të pedagogëve të rinj nga pedagogë me eksperience dhe c) nepermjet vlerësimit të performancës së çdo pedagogu mbi baza viti akademik. Analiza e këtyre elementeve bëhet në rang departamenti dhe konkludohet në 2 dokumenta baze - analiza e punës mësimore dhe analiza e punës shkencore. Këto dokumenta që i bëhen të njohura dhe diskutohen në departament i përcillen më pas dekanatit dhe më pas integrohen në raportet e analizës në rang Fakulteti dhe në rang Universiteti.</p> <p>Procesi I kundërt nga lart-poshtë nënkupton mbledhjen e informacioneve në rang universiteti për cilësinë dhe pas përpunimit, kalimin e tyre deri në nivel departamenti dhe programi studimi.</p> <p><i>Analiza Mësimore dhe Shkencore e FEAs, 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022.</i> <i>Analiza Mësimore dhe Shkencore e UBT, 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022.</i> <i>Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.</i> <i>Relacion për axhustime në kurrikulën e bachelorit në FEA 2022</i></p>

<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Duhet theksuar se procesi i vlerësimit i realizuar në kuadër të monitorimit të cilësisë rezulton ose bazohet në analizat vjetore të bëra në nivel fakulteti dhe në nivel institucional. Sipas dokumentacionit dhe evidencave të paraqitura nuk kemi një analizë në rang departamenti për të evidentuar raportet e vlerësimit për këtë program studimi. Duke u bazuar në dokumentat dhe evidencat që na janë paraqitur mendojmë se analizat në nivel FEA janë të përshtatshme në nivel fakulteti, por nuk evidentojnë rezultatet e pritshme dhe ato të arritura si edhe masat e marra për adresimin e mangësive për këtë program studimi, por ka disa nga këto të dhëna për programet e tjera të studimit në nivele të ndryshme në këtë fakultet.</p> <p>Gjithashtu sygjerohet që të ketë një strukturim më të përshtatshëm të disa të dhënave sasiore, bazuar mbi rezultatet e pritshme dhe krahasimin me ato të arritura. Një shembull do të ishte tabela e studentëve të diplomuar: Numri I pritshëm I të diplomuarve krahasuar me numrin aktual të të diplomuarve për cdo program studimi.</p> <p><i>Analiza Mësimore dhe Shkencore e UBT, 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022</i> <i>Raporti i Analizës Mësimore-Kërkimore FEA, 2019-2020, 2020 -2021, 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmëskademiq e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Në kuadër të vlerësimit të programit të studimit ka disa prej metodave të drejtpërdrejta që përdoren për të evidentuar mbarëvajtjen dhe problemet. Kështu mund të përmendim vlerësimin e kurrikulës pasi mund të evidentohet që kanë ndodhur ndryshime bazuar përmirësimet e vazhdueshme të syllabuseve të lëndëve apo metodave të përdorura, të evidentuara në analizat vjetore. SA u përket vlerësimeve të provimeve apo detyrave si dhe vëzhgime në auditor, edhe këto realizohen si pjesë e metodave të drejtpërdrejta dhe kjo doli nga takimi me pedagogët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu analizat bëhen edhe bazuar mbi rezultatet e provimeve të ndryshme si ai i diplomimit ku evidentohen notat mesatare.</p> <p>Përveç metodave të drejtpërdrejta, edhe metodat e tërthorta shërbejnë për vlerësimin e realizimit të mbarëvajtjes së cilësisë së këtij programi studimi. Sic u shpjegua edhe në kriteret më lart, sondazhet e studentëve bëhen 2 herë në vit duke dhenë rezultatet. Gjithashtu bëhen edhe sondazhe të Alumni për të evidentuar rezultatet në tregun e punës, ndërsa mungojnë sondazhe tek punëdhënësit apo institucionet bashkëpunuese për realizimin e programit të studimit.</p> <p><i>Analiza Mësimore dhe Shkencore e UBT, 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022</i> <i>Raporti i Analizës Mësimore-Kërkimore FEA, 2019-2020, 2020 -2021, 2021-2022.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me përgjegjës të departamentit dhe pedagogët e programit</i></p>

	<p><i>Format pyetësori për vlerësimin e procesit mësimor</i></p> <p><i>Pyetesori online i studentëve UBT 2019</i></p> <p><i>Raport panairi i Karrierës</i></p>		
Konkluzione	<p><i>Shkalla e përmbushjes së këtij standarti është plotësisht pasi institucioni përmbush kushtet për monitorimin dhe vlerësimin e programit të studimit, përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësiti akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Manuali I sigurimit të cilësisë parashikon të gjitha politikat dhe procedurat e brendshme për sigurimin e cilësisë dhe paraqet gjithashtu aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të interesuar. Ai paraqet rolin e institucioneve drejtuese, si senati akademik, zyra e sigurimit të cilësisë, departamenti dhe fakulteti, si orientuese dhe analizuese të të dhënave të cilësisë apo dhe vendimmarrëse në drejtim të përmirësimit të saj bazuar mbi të dhënat e mbledhura. Gjithashtu paraqet rolin e pedagogëve dhe studentëve si burim të dhënash për evidentimin e arritjeve dhe problemeve gjatë procesit të mësimdhënies. Roli I studentëve u tregua edhe më lart me përmbushjen e detyrimit për plotësimin e sondazheve për studentin , dy here në vit. Roli I pedagogëve është për vlerësimin e punës vetjake apo dhe të kollegëve, në rang departamenti. Nuk ka formularë vetëvlerësimi të punës apo vlerësimi të punës së kolegëve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësiti, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Statuti i UBT përcakton të gjitha strukturat, me përgjegjësitë dhe detyrat e tyre si për njësiti edhe për studentët, pedagogët dhe palët e interesuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Kështu thekson rolin e DVBSK në nivel institucional dhe NJSB-të në nivel fakulteti , duke përcaktuar detyrat e tyre gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë. Gjatë vizitës në institucion u vërejt se detyrat e kësaj njësie aktualisht po realizohen sic duhet për të përmbushur procesin dhe zbatuar me rigorozitet rregulloret dhe statutin.</p> <p><i>Manuali i Cilësisë UBT, 2018</i> <i>Statuti I UBT, 2021, neni 83</i> <i>Rregullore e DVBSK, 2021.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja</p>	<p>Përfshirja e njësive bazë dhe kryesore janë themelore për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Nga sa u përmend edhe në standardin VI 3 si dhe në kriteret e mësipërme të këtij standarti, pedagogët e njësive bazë japin</p>

e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	<p>vlerësimet e tyre në mbledhjet me synim analizën e mësimdhënies dhe të kërkimit. Procesi përfshin gjithashtu fakultetin sepse informacioni përcillet në nivel fakulteti për tu përpunuar më tej në analizat vjetore. Personeli ndihmës akademik dhe administrative gjithashtu përfshihet me dhënien e mendimeve sipas kompetencave. Studentët përfshihen përmes sondazheve me frekuencën e përcaktuar.</p> <p><i>Manuali i Cilësisë UBT, 2018</i> <i>Statuti I UBT, 2021, neni 83</i> <i>Rregullore e DVBS, 2021.</i></p>		
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Përfshirja e të gjithë aktorëve të brendshëm garanton dhe respekton integritetin akademik dhe shmang diskriminimet apo pabarazitë. Kjo garantohehet nëpërmjet Manualit të cilësisë si dhe formateve të miratuara të pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor. Miratimi i tyre si edhe marrja përsipër e ruajtjes së konfidencialitetit dhe të dhënave personale garantohehet si nga departamenti ashtu edhe nga rregulloret përkatëse.</p> <p>Sa i përket ekspertëve të jashtëm, gjatë procesit të vlerësimit nuk ka të tillë, por janë konsideruar mendime nga profesionistë dhe kompanitë dhe organizatat me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, si burime të informacionit për vlerësimin e programit ose mdoleve apo pjesëve të tij, kjo sidomos për modulën e praktikës mësimore.</p> <p><i>Manuali i Cilësisë UBT, 2018</i> <i>Statuti I UBT, 2021, neni 83</i> <i>Rregullore e DVBS, 2021.</i></p>		
Konkluzione	<p><i>Shkalla e përmbushjes së standardi është plotësisht duke qenë se aktorët e brendshëm apo edhe të jashtëm janë përfshirë përgjithësisht mirë në proceset e vlerësimit të programit të studimit.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Njesia baze që ka të drejtën dhe profesionalizmin e përmirësimit, ndryshimit, rregullimit apo propozimit të kurikulave të reja është departamenti. Nga ana tjetër, institucioni ndërton një skemë/procedure të tilla të kontrollit dhe menaxhimit të të gjithë ndryshimit të përvitshëm, dhe e standartizon atë përmes kanaleve përmes të cilave vijon i gjithë procesi. Duke kaluar përmes viteve, e gjitha kjo kthehet në një procedure të nevojshme e cila përcëson përmirësimin e procesit por edhe rrit cilësinë.</p> <p>UBT ka parashikuar politika dhe strategji për organizimin dhe veprimtarinë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në dokumentet më të rëndësishme të tij të cilët janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p><i>Statuti UBT, 2017, Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë, Kreu IX, neni 69, fq 42.</i> <i>Rregullorja e Studimeve UBT, 2017, Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë Kreu XIII, Neni 90, Fq 56.</i> <i>Manuali i Sigurimit të Cilësisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rezultatet finale të përfituara prej pyetësorëve bëhen publike, duke ja komunikuar stafit por duke i përfshirë si pjesë integrale e Analizave të Veprimtarive Mësimore e Kërkimore të <i>DMTR_s (Aneks 25 Raporti i Analizës Mësimore-Kërkimore MTR 2017-2018, i miratuar më datë 03. 12. 2018).</i></p> <p>Të dhënat e rezultatet bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe atyre vjetore të ZSCVI nga njëra anë dhe Raportit Vjetor të Përgjithshëm që përgatitet në fund të çdo viti akademik. Për kryerjen e vlerësimit përdoren metoda të shumëllojshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Këtu përfshihen sondazhet, intervistimet anonime me shkrim dhe në mjedise auditoresh ballë për ballë, pjesëmarrje në mbrojtjen e tezave, ndjekjen e ecurisë së studentëve, punësimin, opinionet e tyre mbi rezultatet e të nxënit dhe orientimit në tregun e punës, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Institucioni ka të zyrtarizuar Planin Strategjik të UBT 2016-2025. Në këtë dokument janë të përshkruara politika dhe procedurat që do të ndjeko institucioni gjatë gjithë kësaj periudhe.</p> <p>UBT operon me procedura të sigurimit të cilësisë që orrojnë transparencë dhe për të gjithë aktorët. Të gjitha strukturat e institucionit sigurojnë një shërbim cilësor dhe nxisin rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet. Personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në zbatimin e planeve të masave që dalin nga mbledhjet e departamentit dhe fakultetit që parashtrojnë analizat vjetore të bëra. Cdo zbatim apo plan bëhet në bashkëveprim të vazhdueshëm me Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor të Institucionit dhe me DVBSK që ka përgjegjësinë institucionale në UBT sa i përket sigurimit të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UBT, vlerëson dhe favorizon përshkallëzimin e metodikës në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këtë kuadër përfshirja dhe aktivizimi i të gjithë aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është një nga objektivat kryesore të IAL në këtë drejtim.</p> <p>UBT është gjithashtu shumë transparente lidhur me çfarëdo informacioni, mase apo aktiviteti që duhet të ndërmeret lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Transparenca duket qartë në mbledhjet e departamentit të DEPZHR apo dhe të vetë rektoratit me asamblenë. UBT mendon se fryma e transparencës që ajo ka arritur të aplikojë, është baza e shmangies të çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Megjithëse jo akoma në formë të institucionalizuar, Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe departamenti konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me aktorë</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>të jashtëm dhe palë të treta, me qëllim përmiresimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Institucioni përmes pyetësorëve dhe përmes mbledhjeve të hapura të asamblesë ndërgjegjëson studentët dhe personelin për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit të cilësisë në universitet.</p> <p><i>Manuali i Sigurimit të Cilësisë.</i> <i>Plani Strategjik UBT, Qershor 2016-2025, Pjesane Parë, Kreu 5, fq 42 si dhe Pjesa e Dytë, Kreu 6, fq 84</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Shkalla e përmbushjes së standardit është plotësisht pasi transparenca dhe gjithëpërfshirja e aktorëve në zbatim garantohej nga strukturat e mirëpërcaktuara në detyrime dhe përgjegjësi apodhe të drejta, si dhe nga eksperiencia institucionale në këto drejtime.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural" të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Bujqësor i Tiranës"

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Eksperiencë e gjatë institucionale në ndërrimin e strategjisë së duhur për programin e studimit duke u bazuar në përvojat e kaluara dhe parashikimet për të ardhmen mbi numrin e aplikantëve dhe përvojën e brashëve të institucionit në të gjitha nivelet. Departament, Fakultet dhe Universitet
2. Staf akademik me përvojë dhe me kualifikimet e duhura për të mbështetur këtë program studimi.
3. Struktura të mirëndërtuara brenda institucionit si dhe brenda fakultetit e departamentit për mbështetjen me projekte dhe rritjen e cilësisë në përgjithësi dhe për programin e studimit në veçanti.
4. Departamenti në EPZHR-ja është njësi bazë unike në mbarë vendin dhe programi Bachelor "Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit Rural", që ofrohet në përputhje me fushat e ekspertizës që disponon ky departament, është gjithashtu unik, duke krijuar mundësi të mira në tregun e punës për ofrimin e profesionistëve aq të nevojshëm në politikat e zhvillimit rural.


Pika të dobta:

1. Njohuritë teknike dhe të specializuara në lidhje me zhvillimin rural që merren në kurset përkatëse aplikohen gjatë praktikave profesionale, por më pak pjesa e lëndëve dhe kurseve më të përgjithshme në ekonomi dhe financë. Niveli i aplikimit të tyre duhet të jetë më i lartë.
2. Ka disa mungesa jo me rëndësi të lartë në aspektin e mbështetjes së programit me teknologjinë e informacionit, si p.sh. mungesë e moduleve dhe përpunim të dhënash në sistemin e menaxhimit të informacionit, por që duke u përmirësuar do të rritnin kapacitetet menaxhuese.

Rekomandime:

1. Aplikimi në një nivel më të lartë në praktikat profesionale i pjesës së njohurive teknike të specializuara e të lidhura me fushat specifike të zhvillimit rural, gjë e cila mund të realizohet përmes praktikave mësimore si edhe një rishikim të mundshëm brenda lëndëve me zgjedhje
2. Lidhur me shtimin e menaxhimit të informacionit, duhet bërë zhvillimi i duhur për pjesët e munguara, p.sh. lidhur me ruajtjen dhe dërgimin e materialeve tek studentët, Eëb-site në anglisht duke qenë se synohen edhe mobilitete të pedagogëve e studentëve të huaj, përpunimi i të dhënave të studentëve nëpërmjet sistemit.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "..." provided by the Higher Education Institution "..."



Strengths and affirmations


1. Long institutional experience in building the right strategy for the study program based on past experiences and future predictions on the number of applicants and the internal experience of the institution at all, Department, Faculty and University levels.
2. Academic staff with the right experience and appropriate qualifications to support this study program.
3. Well-built structures within the institution as well as within the faculty of the department for project support and quality enhancement in general and especially for the study program.
4. The department in EPHRD is a unique basic unit throughout the country and the Bachelor program "Economics and Policies of Rural Development", which is offered in accordance with the areas of expertise that this department has, is also unique, creating good opportunities in the market of work for the provision of professionals so needed in rural development policies.

Weaknesses

1. The technical and specialized knowledge related to rural development that is obtained in the relevant courses is applied during professional practices, but less than the part of the more general subjects and courses in economics and finance. The level of their application should be higher.
2. There are some low importance deficiencies, in terms of supporting the program with information technology, such as the lack of modules and data processing in the information management system, but which, being improved, would increase the management capacities.

Recommendation

1. Application at a higher level in professional practices of the part of specialized technical knowledge related to the specific fields of rural development, which can be realized through teaching practices as well as a possible review within elective courses.
2. Regarding the information management system, proper development should be done for the missing parts, e.g. related to the storage and delivery of materials to students, the website in English since the mobility of lecturers and foreign students is also intended, the processing of student data through the system.

Two handwritten signatures in black ink are located at the bottom left of the page. The first signature is large and stylized, appearing to read 'Leyva'. The second signature is smaller and more cursive, appearing to read 'Dorador'.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS				
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË ÇIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
				X